

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5958
E enjte, 19 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Balkani, fushëbeteja e luftës së re të Rosisë kundër Perëndimit (1)

Dr. Enver
HOXHAJ



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E KOSOVËS NUK DO TË MARRË PJESE AS NË SAMITIN E DURRËSIT

FAQE 4-5

KOSOVA PËRSËRI E REFUZON FTESËN PËR MINISHEGENIN

OPINION

MINISHENGENI, NISMË E
PARAKOHSHME DHE E
RREZIKSHME PËR KOSOVËN,
MADJE EDHE PËR SHQIPËRINË

F. 11

Nga: Prof. dr.
Ibrahim GASHI



AKTUALE

KËRKOHEM ANGAZHIM MË
SERIOZ PËR ZBATIMIN
E LEGJISLACIONIT PËR TË
DREJTAT E NJERIUT F. 6

EDITA TAHIRI: SERBIA
NUK ËSHTË E INTERESUAR
PËR DIALOG F. 3

EKONOMI


DOGANA PRANON DONACION
12 000 EURO NGA QEVERIA
AMERIKANE F. 9

LLUKA NDAN MIRËNJOHJE
PËR KONTRIBUTDHËNËSIT
NË SEKTORIN MINERAR F. 9

KULTURË

ANATOMIA E NJË
LUFTËTAREJE NË LIBRIN
'BLEIBENDE SPUREN' F. 14

Lulëzim
ETEMAJ



Republika e Kosovës nuk do të marrë pjesë as në Samitin e Liderëve të Ballkanit Perëndimor që do të mbahet në Durrës më 20 dhe 21 dhjetor. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se në kohën kur Serbia po e pengon konsolidimin e shtetësisë së Kosovës dhe po i mohon

masakrat e kryera gjatë luftës, iniciativat për bashkëpunim rajonal janë krejtësisht të pakuptimta. Edhe njohësit e marrëdhënieve ndërkom-bëtare dhe analistët politikë këtë iniciativë rajonale e kanë vlerësuar të parakohshme dhe të rrezikshme për Republikën e Kosovës

KRYETARI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK), ISA MUSTAFA, KA MBAJTUR TAKIM ME ANËTARËT E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË PARTISË

LDK-ja e do postin e presidentit ose shkon në opozitë



Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, shpreson se para 26 dhjetorit do të arrihet marrëveshja me Lëvizjen Vetëvendosje. Ai ka bërë me dije se LDK-ja për postin e presidentit ia ka ofruar edhe një ministri më shumë Lëvizjes Vetëvendosje. Mustafa ka thënë se posti i presidentit nuk duhet t'i bllokojë bisedimet për bashkëqeverisje me LV-në, në të kundërtën ka thënë se partia që drejton ka edhe planin "B" për të dalë në opozitë

FAQE 3

Në janar vijnë në Kosovë ekspertët gjermanë për sigurimet shëndetësore

FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kuvendi i Shqipërisë miraton paketën "anti-shpifje"

TIRANË, 18 DHJETOR - Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar të mërkurën në mbrëmje paketën "anti-shpifje", e cila ka shkaktuar shumë debate ditët e fundit midis gazetarëve dhe mazhorancës socialiste.

Ishin 82 deputetë që dhanë votën e tyre për paketën, për të cilën kryeministri Edi Rama thotë se do t'i luftojë lajmet e rreme dhe shpifjet në median online, ndërsa gazetarët e konsiderojnë kapje dhe kontroll mbi median.


Vetëm 13 deputetë u shprehën kundër kësaj pakete, 5 abstenuan dhe 5 deputetë nuk morën pjesë në votim.

Me paketën e re, Autoriteti i Mediave Audiovizive merr kompetenca për gjobitjen dhe deri në mbylljen e portaleve nëse gjykon se kanë publikuar shpifje apo lajme të rreme. Gazetarët argumentojnë se AMA nuk mund të marrë kompetenca që i takojnë gjykatës.

Tashmë do të jetë presidenti i Republikës që do të vendosë

nëse do ta dekretojë ligjin apo do ta rikthejë për shqyrtim në Parlament.

Ndërkaq, të mërkurën dhjetëra gazetarë, përfaqësues të organizatave të ndryshme të medias, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile, apo dhe të politikës, u mbledhën të mërkurën përpara parlamentit për të protestuar kundër së ashtuquajturës "paketë antishpifje". Ata mbanin shalle të zinj në gojë dhe parulla si: "Mos na prek fjalën" dhe "Rama nuk na e mbyll dot gojën".



Diaspora shqiptare, rreth 1.6 milion

Në një studim të publikuar nga Instituti Shqiptar i Statistikave, thuhet se në vitin 2019, sipas vlerësimeve të tërthorta, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1.64 milion shtetas jashtë vendit, ose rreth 36 % të shtetasve shqiptarë gjithsej


TIRANË, 18 DHJETOR - "Në vitin 2019, sipas vlerësimeve të tërthorta, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1.64 milion shtetas jashtë vendit, ose rreth 36 % të shtetasve shqiptarë gjithsej", thuhet në një studim të publikuar në Shqipëri nga Instituti Shqiptar i Statistikave. Studimi "Diaspora shqiptare 2019" vëren se e ashtuquajtura "diaspora e vjetër" përbëhet nga emigrantë që kanë emigruar para vitit 1944, të cilët konsiderohen diasporë shumë e hershme, si dhe nga ata që u larguan gjatë viteve 1945-1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi".

"Diaspora e re" përbëhet nga emigrantët që kanë emigruar pas viteve 1990 dhe përkon me valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit. Diaspora e vjetër ka qenë e vendosur kryesisht në ShBA dhe disa vende të Evropës Perëndimore, ndërsa diaspora e re është vendosur në Greqi, Itali,

Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë etj., dhe më pak në vendet e diasporës së vjetër", vlerëson studimi.

Studimi vlerëson se gjatë viteve 1990-1994 numri i emigrantëve shqiptarë në Greqi, Itali dhe ShBA rritej çdo vit me rreth 30 % të numrit të vitit paraardhës. Por këto norma bien në rreth 11 % gjatë periudhës 1995-1999, vlerëson studimi. "Pas vitit 2000 norma e rritjes së numrit të emigrantëve shqiptarë në Greqi bie me shpejtësi dhe arrin në nivele negative gjatë periudhës 2010-2019. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, numri gjithsej i emigrantëve shqiptarë në Greqi po zvogëlohet. Gjatë periudhës 2015-2019, edhe në rastin e Italisë dhe ShBA-së, norma vjetore e rritjes së numrit të emigrantëve është zvogëluar në mënyrë konstante, duke arritur në rreth 3 %".

Sipas studimit "Diaspora Shqiptare 2019" nga ana tjetër



numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani ka ndryshuar me ritme të tjera nga ato të Italisë, Greqisë dhe ShBA-së. "Gjatë viteve 1990-1994 ky numër rritej me rreth 10 % në vit. Më pas norma vjetore e rritjes u zvogëluar në mënyrë konstante, duke arritur në rreth 1 %, përgjatë periudhës 2010-2014. Vetëm pas vitit 2015, me një normë vjetore prej rreth 35 %, duke e kthyer këtë vend si destinacionin kryesor të tyre. Kjo ka bërë që pesha që zënë emigrantët shqiptarë në Gjermani, në numrin gjithsej të emigrantëve, të katërfishohet nga 1,3 % në 4,2 %".

Migrimi i jashtëm dhe lëvizjet e brendshme kanë pasur ndikim të madh dhe të përvitshëm në popullsinë e qarqeve të Shqipërisë. Nga të dhënat vihet re se popullsia banuese e të gjitha qarqeve të vendit është në mënyrë domethënëse më e vogël sesa popullsia e regjistruar në regjistrat e gjendjes civile. Qarku i Gjirokastrës dhe ai i Vlorës janë dy qarqet e vetme ku popullsia banuese është më pak se gjysma e popullsisë së regjistruar, përkatësisht me 41,1 % dhe 49,0 %. Nga ana tjetër për qarqet e tjera ky raport luhet nga 54,4 % në Berat në 79,3 % në Tiranë.

Shqipëria vazhdon dhe do të vazhdojë të përjetojë flukse dalëse të popullsisë, ashtu sikurse projeksionet e popullsisë sugjerojnë. Në këtë mënyrë popullsia e Shqipërisë po shkon drejt procesit të plakjes si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë dhe për më tepër emigracionit i cili vazhdon të mbetet veprues dhe që përfshin një popullsi relativisht të re", thuhet aty. Studimi pohon se në vitin 2018, në popullsinë mesatare gjithsej të Shqipërisë, të rinjtë 0-14 vjeç zënë 17,5 %, popullsia në moshë pune 15-64 vjeç zë 69,8 % dhe popullsia mbi 65 vjeç përbën 12,8 % të popullsisë gjithsej.

Pendarovski: Ligji për gjuhën shqipe është kushtetues

SHKUP, 18 DHJETOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka mbrojtur të mërkurën Ligjin për përdorimin e gjuhëve për të cilin raporti i Komisionit të Venecias kishte vërejtje të shumta.

Në fjalimin e fundvitit të Kuvendit maqedonas, Pendarovski tha se megjithatë Komisioni i Venecias nuk ka dalë me qëndrimin se ligji është antikushtetues dhe se dis-

pozitat e tij madje janë më të larta sesa ato të konventave ndërkom-bëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Por, ai ka tërhequr vërejtjet nga vështirësitë që mund të dalin në zbatimin e tij në praktikë, në veçanti në gjyqësor, që ishte edhe një nga vërejtjet kryesore të Komisionit të Venecias. "Juristët e lartë evropianë me të drejtë thonë se shteti ynë në këtë moment nuk

ka kapacitet dhe resurse që t'i zbatojë këto standarde në proceset gjyqësore dhe drejtuese. Me fjalë të tjera, çfarë fitohet nga ligji nëse dispozitat e tij mbeten vetëm në letër", ka deklaruar presidenti Pendarovski.

Ai ka kritikuar edhe zhvillimet në gjyqësor duke kërkuar përgjegjësi për secilin që me pagë shtetërore ka arritur të bëhet milioner. "Thuaje tri dekada jemi shtet i pavarur, por

ende asnjë politikan i lartë apo afarist i pasuruar brenda një nate nuk ka përfunduar pas grillave, kurse aty duhej të përfundonin më shumë se një. Perceptimi te qytetarët është se vetëm të varfrit dhe njerëzit që janë në margjina pa ndonjë relacion me ndonjë pushtet mbajnë përgjegjësi madje edhe për vepra penale për asgjë", ka theksuar Pendarovski.

Kreu i këtij shteti ka kërkuar nga të



gjitha institucionet shtetërore por edhe faktorë të tjerë që bashkërisht të punojnë për arritjen e synimit kryesor të vendit, anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka mbajtur takim me anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të partisë

LDK-ja e do postin e presidentit ose shkon në opozitë



Lëvizjen Vetëvendosje për koalicionin e mundshme. LDK-ja mbetet e përkushtuar që të vazhdojmë edhe më tutje për të arritur një koalicion me LV-në. Ky koalicion nuk duhet të shikohet si rival politik, por i partneritetit për të bërë ndryshime në qeverisjen më të mirë të vendit, për t'i ofruar perspektivë zhvillimore vendit. Këshilli ishte i bindur që në këtë marrëveshje duhet të vlerësohet karshi votave të qytetarëve qoftë në ndarjen e përgjegjësisë dhe në programin qeverisës", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se posti i presidentit nuk duhet t'i bllokojë bisedimet për bashkëqeverisje me LV-në. Mustafa ka bërë me dije se i kanë ofruar LV-së një ministri më shumë për postin e presidentit, por që nuk e ka pranuar. "Ne kemi dhënë një propozim se si ta kapërcejmë këtë pengesë dhe nuk kam parë atë gatishmëri të LV-së dhe kemi propozuar që ne të japim edhe një ministri për postin e presidentit, pra ne t'i kemi katër ministri e ata gjashtë", ka deklaruar Mustafa.

Lideri i LDK-së ka thënë se partia që drejton ka edhe plan "B" nëse nuk u jepet posti i presidentit. "LV na ka pyetur se a kemi plan B. Ne i kemi thënë se plani është të shkojmë në opozitë", është shprehur Mustafa. Ai ka thënë se vonesat për moskrijimin e institucioneve janë përgjegjësi e partisë që ka dalë e para në zgjedhjet e 6 tetorit.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, shpreson se para 26 dhjetorit do të arrihet marrëveshja me Lëvizjen Vetëvendosje. Ai ka bërë me dije se LDK-ja për postin e presidentit ia ka ofruar edhe një ministri më shumë Lëvizjes Vetëvendosje. Mustafa ka thënë se posti i presidentit nuk duhet t'i bllokojë bisedimet për bashkëqeverisje me LV-në, në të kundërtën ka thënë se partia që drejton ka edhe planin "B" për të dalë në opozitë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, pas mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm të kësaj partie, në një konferencë për media të mbajtur të mërkurën, ka thënë se shpreson që para datës 26 dhjetor të arrihet marrëveshja

me Lëvizjen Vetëvendosje. "Kisha dashur që koalicioni të lidhet para datës 26 dhjetor", ka thënë ai.

Mustafa ka theksuar se i ka njoftuar anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së për ecurinë e bisedimeve me LV-në. "I informova anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, deputetët e zgjedhur dhe kryetarët lidhur me ecurinë që kemi pasur me

Edita Tahiri: Serbia nuk është e interesuar për dialog

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar të mërkurën konferencën "Ruga drejt marrëveshjes finale Kosovë - Serbi". Në këtë konferencë ishte e pranishme edhe ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, e cila ka thënë se nuk ka qartësi nga bashkësia ndërkombëtare për planin gjeopolitik dhe se në vend se të shkohej drejt arritjes së një marrëveshje Kosovë - Serbi, bisedimet shkuan në biseda për ndarje të territoreve. "Çështja e marrëdhënieve ndërshtetërore në mes të Kosovës - Serbisë është në një fazë kur edhe faktori ndërkombëtar duhet të ketë një qartësi, e tani për tani nuk ekziston në planin gjeopolitik. Në

vend se procesi i bisedimeve të shkonte rreth arritjes së një marrëveshjes së qëndrueshme debati u zhvendos në çështje kufijsh dhe tregoi se Ballkani si ka kryer ende punët. Ne po dalim me ide të dëmshme, siç ishte ndarja e territorit dhe pati edhe përkrahës siç ishte presidenti, dialogu nuk u ndal për taksën, por për copëtim të territorit. Pa njohje reciproke në kufijtë aktualë nuk do të ketë paqe të qëndrueshme. Do të ketë luftë", ka deklaruar Tahiri.

Ajo ka theksuar se BE-ja dhe ShBA-ja duhet të marrin një qëndrim sa i përket procesit të dialogut. "Serbia nuk është e interesuar për dialog. Duhet të ketë një plan ndërkombëtar, t'i thuhet Serbisë se nëse nuk e njeh



Kosovën, nuk do të anëtarësohet në BE. Duhet t'i pamundësohet e drejta e vetos. Kapitullin e 35-të që e ka Serbia, pra e ka vetëm

Serbia, dhe në kapitullin e 35-të thuhet se Serbia duhet të përfshihet në një marrëveshje ligjërish të obligueshme", ka thënë Tahiri. Ajo

ka shtuar se është për keqardhje që në Serbi është një president që ende e mohon gjenocidin në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS NUK DO TË MARRË PJESË AS NË SAMITIN E DURRËSIT

Kosova refuzon përsëri ftesën për minishegenin

Republika e Kosovës nuk do të marrë pjesë as në Samitin e Liderëve të Ballkanit Perëndimor që do të mbahet në Durrës më 20 dhe 21 dhjetor. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se në kohën kur Serbia po e pengon konsolidimin e shtetësisë së Kosovës dhe po mohon masakrat e kryera gjatë luftës, iniciativat për bashkëpunim rajonal janë krejtësisht të pakuptimta. Edhe njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analistët politikë këtë iniciativë rajonale e kanë vlerësuar të parakohshme dhe të rrezikshme për Republikën e Kosovës



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se e ka refuzuar ftesën e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për të marrë pjesë në takimin rajonal të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Përmes një postimi në profilin e vet në

"Facebook", Thaçi ka treguar arsyet e refuzimit, duke thënë se në kohën kur Serbia po e pengon konsolidimin e shtetësisë së Kosovës dhe po mohon masakrat e kryera gjatë luftës në Kosovë, iniciativat për bashkëpunim rajonal janë krejtësisht të pakuptimta. Ai ka falënderuar kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi

Rama, për ftesën, duke i shprehur mirënjohjen më të lartë për mbështetjen e vazhdueshme të Republikës së Shqipërisë për Kosovën. "Mbështetja dhe bashkëpunimi reciprok ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është i natyreshëm dhe i përhershëm. Mirëpo, për dallim nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës vazhdon edhe më tutje të ketë pengesa serioze në konsolidimin e shtetësisë së vet. Fatkeqësisht, pengesa kryesore vjen nga Serbia, e cila në të gjitha format dhe mundësitë në mënyrë të vazhdueshme minon përpjekjet tona për konsolidimin e shtetësisë sonë", ka shkruar Thaçi.

Ai ka treguar se për sa kohë Serbia dhe Bosnja nuk e njohin Kosovën si shtet, Kosova nuk do të marrë pjesë në iniciativa të tilla. "Serbia ka kryer gjenocid kundër qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe sot jo vetëm që mohon krimet e kryera, por vazhdon të mos e pranojë ekzistencën e shtetit tonë. Në një situatë të tillë thirrjet dhe iniciativat për bashkëpunim rajonal janë krejtësisht të pakuptimta. Serbia dhe Bosnje Hercegovina nuk e njohin shtetin e Kosovës. Kjo nënkupton se këto dy shtete nuk duan fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me Kosovën. Prandaj, për aq kohë sa nuk do të ketë njohje reciproke me këto shtete, nuk mund të ketë përparim në aspektin e bashkëpunimit rajonal", ka vlerësuar Thaçi, duke shtuar se Kosova synon anëtarësim në NATO e BE dhe jo të bëhet pjesë e iniciativave eksperimentale rajonale, që janë rezultat i paafetësisë së BE-së për t'ia hapur dyert e anëtarësimit shteteve të Ballkanit Perëndimor. "Në fund, dua të theksoj se rrethanat që e

kanë pamundësuar pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës në takimin e parë të mbajtur në Novi Sad dhe në të dytin të mbajtur në Ohër nuk kanë ndryshuar. Si rrjedhojë, unë si president i Republikës së Kosovës, në emër të institucioneve shtetërore, refuzoj pjesëmarrjen në takimin e tretë të këtij formati rajonal që mbahet në Tiranë", ka shkruar Thaçi.

Kjo iniciativë rajonale e njohur si minishengen ballkanik është parë me skepticizëm edhe nga njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analistët politikë. Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë për "Epokën e re" se iniciativa e minishengenit është një nismë e parakohshme dhe e rrezikshme për Kosovën edhe për Shqipërinë. "Ideja vjen në një kohë kur ka një ngecje të plotë në procesin e dialogut Prishtinë - Beograd, i cili, sipas diplomacisë perëndimore, po konsiderohet si rruga e vetme për ta ç'tensionuar rajonin. Nëse është kështu, atëherë pashmangshëm shtrohen së paku dy pyetje kryesore: e para, përse Serbia po insiston në këtë nismë? Dhe e dyta, përse Shqipëria është rreshtuar në mbështetje të kësaj nisme, kur vendet e tjera të rajonit, përveç Maqedonisë së Veriut, e kanë bojkotuar?", ka thënë Gashi. Sipas tij, Serbia po e përkrah këtë iniciativë për interesa ekonomike. "Mund të thuhet se përmes kësaj iniciative po tenton ta zhvendosë presionin ndërkombëtar për vazhdimin e dialogut me Kosovën dhe duke e pasur Shqipërinë në mbështetje, po provon ta anashkalojë shtetin e Kosovës. Për më shumë, Serbia po luan në kartën më të rrezikshme që për shqiptarët në

Ballkan duhet biseduar vetëm me Tiranën zyrtare", ka vlerësuar Gashi, duke shtuar se justifikimet e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për këtë iniciativë po tingëllojnë jo shumë bindëse dhe naive.

Edhe analisti politik Shkëlzen Maliqi këtë iniciativë rajonale e ka quajtur si gjysmake. Sipas tij, është e vështirë të ketë sukses një iniciativë e cila ka përçarë rajonin. "Nëse je përkrahës i bashkëpunimit të ngushtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk mund të mohohet rëndësia e samiteve, edhe të këtij në Durrës, por është vështirë të ketë pajtim me nismën gjysmake që shkaktoi çarjen në dy blloqe të rajonit. Nisma gjysmake kontribuoj në diçka që është absolutisht e kundërta e intencave të mira, sepse fuqizoi mosbesimin dhe dyshimet se pas ngutisë së treshes Vuçiq, Rama, Zaev fshehet një rrezik që nuk mund të neglizhohet me besim të verbër, se projekti është frymëzuar nga intencat e mira", ka shkruar Maliqi, duke shtuar se tri vendet iniciuese të kësaj iniciative u ngutën pak. "Mendoj se Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia gabuan që në Novi Sad, ndonëse në atë moment të motivuara me përmbushjen e interesave të tyre të veçanta në raport me BE-në, inauguruan projektin e minishengenit pa koordinimin paraprak me tri vendet e tjera", ka vlerësuar Maliqi.

Samiti i Liderëve të Ballkanit Perëndimor që do të mbahet në Durrës më 20 dhe 21 është vazhdimësi e samiteve që janë mbajtur në fund të këtij viti në Novi Sad dhe Ohër, ku Republika e Kosovës nuk ka marrë pjesë. Këtë iniciativë rajonale deri më tani e kanë kundërshtuar të gjithë liderët politikë të Kosovës.

MINISHENGENI, NISMË E PARAKOHSHME DHE E RREZIKSHME PËR KOSOVËN, MADJE EDHE PËR SHQIPËRINË



Nga: Prof. dr. Ibrahim GASHI

Iniciativa e Serbisë, e mbështetur nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, për krijimin e një minishengenit ballkanik, sado e justifikuar nga iniciatorët si nismë që është në linjë dhe i kontribuon rajonit në procesin e anëtarësimit në BE, megjithatë, po të analizohet më shumë sens kritik, rezulton se si nismë është e parakohshme dhe krejtësisht e pafavorshme, mbase edhe e rrezikshme për Kosovën, madje edhe për vetë Shqipërinë.

Ideja vjen në një kohë kur ka një ngecje të plotë në procesin e dialogut Prishtinë-Beograd, i cili, sipas diplomacisë perëndimore, po konsiderohet si rruga e vetme për ta ç'tensionuar rajonin. Nëse është kështu atëherë pashmangshëm shtrohen së paku dy pyetje kryesore: E para, përse Serbia po insiston në këtë nismë? Dhe, e dyta, përse Shqipëria është rreshtuar në mbështetje të kësaj nisme, kur vendet e tjera të rajonit, përveç Maqedonisë së Veriut, e kanë bojkotuar? Në pyetjen e parë përgjigja është më e lehtë. Serbia, përpos interesave të mëdha ekonomike dhe tregtare, mund të thuhet se përmes kësaj iniciative po tenton ta zhvendosë presionin ndërkombëtar për vazhdimin e dialogut me Kosovën dhe duke e pasur Shqipërinë në mbështetje, po provon ta anashkalojë shtetin e Kosovës. Për më shumë Serbia po luan në kartën më të rrezikshme që për shqiptarët në Ballkan duhet biseduar vetëm me Tiranën zyrtare. Kjo përbën sfidën e madhe për politikën shqiptare që do të lidhej me pyetjen e dytë çfarë kërkon Shqipëria në këtë nismë? Përgjigja në këtë pyetje, siç po shihet, është më komplekse. Justifikimet e kryeministrit shqiptar E. Rama, se rrethanat kanë ndryshuar dhe se ne duhet të shohim përpara, po tingëllojnë jo shumë bindëse, për të mos thënë edhe naive. Ballkani në përgjithësi dhe shqiptarët në veçanti kanë vuajtur shumë nga ekstremizmi i pushtetit të Serbisë. Madje ky i fundit nuk ka të ndalur. Ai po vazhdon ta pengojë afirmimin e shtetit të Kosovës, të provokojë në mënyrë të paskrupullt viktimat e terrorit dhe gjenocidit serb të viteve 1998-1999 kundër shqiptarëve, duke i quajtur trillime masakrat që i njohu e tërë bota demokratike, pa dallim. Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë nismë i ka venë në pozicion tejet të vështirë (të sikletshëm) liderët e shtetit të Kosovës, duke kërkuar nga ata, pa të drejtë, që t'i bashkohen nismës së këtij minishengenit.

Përgjigja e presidentit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për të mos marrë pjesë në këtë nismë për shkak të Serbisë, ka shumë sens. Ky bojkotim i Kosovës do të duhej të shërbente si një alarm për Shqipërinë dhe lidërshpinin e saj që të reflektojnë në mosthirrjen e Samitit të ardhshëm, me synim që kjo nismë të dështojë, për arsye të rrezikshmërisë që bartë në vete për Kosovën, Shqipërinë dhe rajonin.



Në janar vijnë në Kosovë ekspertët gjermanë për sigurimet shëndetësore

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka pranuar një letër zyrtare nga homologu i tij gjerman, Jens Spahn, i cili konfirmon gatishmërinë e shtetit gjerman për ndihmë ndaj Kosovës për krijimin e sigurimeve shëndetësore. Bashkëpunimi në mes të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Kosovës dhe Fondit të Sigurimit Gjerman, AOK, i cili do të nisë menjëherë në janar të vitit 2020, është një rezultat konkret i një memorandumit të përbashkët të mirëkuptimit që u nënshkrua në korrik të këtij viti.

Gjatë një konferencë për media të mbajtur të mërkurën nga ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ministri Ismaili ka thënë se kjo marrëveshje e bashkëpunimit është një hap i madh drejt realizimit të sigurimeve shëndetësore. "Një

ditë jashtëzakonisht e mirë dhe e rëndësishme për shëndetësinë e Kosovës. Tani po nisim bashkëpunimin konkret me Gjermaninë për të funksionalizuar Fondin e Sigurimit Shëndetësor, projekt ky që buron nga marrëveshja e nënshkruar në korrik me ministrin gjerman Spahn", ka thënë ministri Ismaili. Sipas ministrit Ismaili, projekti do të ndahet në dy faza, e para nga të cilat do të fillojë në janar të vitit 2020.

Në anën tjetër, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka theksuar se janë krenarë që pas punës intensive të të dy ministrive të shëndetësisë, janë harmonizuar hollësitë e bashkëpunimit për ngritjen e Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Kosovës. "Ne jemi të bindur që me një përkushtim të madh të Qeverisë së Kosovës dhe punën e përbashkët të të gjithë aktorëve të përfshirë mund të arrihet përparim thelbësor për qytetarët", ka thënë Heldt.



Kërkohet angazhim më serioz për zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Në kuadër të shënimit të Javës për të drejtat e njeriut, organizuar nga Fakulteti Juridik, të mërkurën u mbajt një tryezë diskutimi me këtë temë, si dhe u prezantua platforma për të drejtat e njeriut, e financuar nga qeveria norvegjeze dhe UNDP. Në këtë tryezë Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, u foli fillimisht studentëve për historikun e institucionit që e drejton. Ai ka thënë se Avokati i Popullit është themeluar rreth 200 vjet më parë në Suedi, ndërsa sot janë 140 vende në botë që e kanë këtë institucion.

Jashari tregoi edhe për gjenezën e themelimit të këtij institucioni në Kosovë ku, siç tha ai, për herë të parë ky emërtim në Kosovë gjendet në dokumentet e mar-



rëveshjes së Rambujesë. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skënder Çoçaj, ka theksuar se mbrojtja e të drejtave të njeriut mbetet sfidë jo vetëm për vendin tonë, por edhe për

vendet që janë në nivel më të lartë të demokracisë. Çoçaj rikujtoi studentët se mbrojtja e të drejtave të njeriut në Kosovë është e drejtë kushtetuese. "Neni 22 i

Kushtetutës së Kosovës siguron aplikueshmëri të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rast konflikti garanton prioritetin e tij në krahasim me ligjet dhe aktet e tjera të institucioneve publike", ka thënë Çoçaj, duke shtuar se Kosova ende nuk ka mundësi t'i ratifikojë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pasi nuk është anëtarë e OKB-së dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Valbona Bogujevci nga UNDP-ja ka theksuar se korniza ligjore e Kosovës garanton gjerësisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por nevojitet angazhim më serioz për zbatimin e legjislacionit. Bahri Hyseni, kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka thënë se KPK-ja po ndërmerr hapa në

drejtim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut me qëllim që për qytetarët të sigurojmë hetime në kohë efektive, procedura efektive për ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe t'i nxjerrin para organeve të drejtësisë ashtu siç e kërkon ligji. "Lufta jonë e përditshme është që të zbatohet drejt legjislacioni dhe në mënyrë të paanshme dhe qytetarët të respektohen me dinjitet dhe në parimet e standardeve evropiane", ka thënë Hyseni.

Në këtë tryezë u bë edhe prezantimi i platformës për të drejtat e njeriut, e cila do të jetë një mjet pune për të gjithë ata që merren profesionalisht me zbatimin e ligjit, por do t'i ndihmojë edhe hulumtuesit shkencorë në këtë fushë.

Ministria e Mbrojtjes nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes së Turqisë

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Faruk Geci, më 16 dhjetor në Ankara të Turqisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes në mes të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Presidencës së Industrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, ndërsa për palën turke

ka nënshkruar kryetari i Presidencës së Industrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, prof. Ismail Demir. Kjo marrëveshje parashihet vazhdimin dhe thellimin e mëtejshëm të raporteve sipas përmbajtjes së marrëveshjes së mëparshme të nënshkruar më 27 tetor 2011 ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së

Forcës të Sigurisë së Kosovës (tani Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës) në lidhje me bashkëpunimin industrial të mbrojtjes të nënshkruar në Ankara. Të dyja palët janë pajtuar që tani t'i zbatojnë objektivat e marrëveshjes në fushat vijuese të bashkëpunimit. Bashkëpunimi duhet të jetësohet duke marrë parasysh interesin e përbashkët dhe nevojat e palëve.



Ballkani, fushëbeteja e luftës së re të Rosisë kundër Perëndimit (1)

Informacioni është shndërruar në armë të fuqishme në luftën e re asimetrike e jolineare të Rosisë kundër Perëndimit. Fushëbetejë vazhdon të jetë Ballkani



Dr. Enver HOXHAI

Në mes të shënimit të 30-vjetorit të rënies së Murit të Berlinit dhe përvjetorit të 70 të themelimit të NATO-s, një shtetas rus vizitoi një ekspozitë anti-NATO në Serbi. Aleksandër Dugin po shihte fotografitë e ekspozuara në galerinë e hapur në Beograd me sloganin "Mbrotjtja 78", në nëntor të këtij viti. Dugin nuk ishte vetëm. Ai po shoqërohej nga ministri serb i Mbrotjtjes, Aleksander Vulin dhe aty tregoheshin fotografi nga bombardimet më 1999. Në komunikatën e lëshuar nga ministria serbe binte në sy një citat i çuditshëm i Aleksander Dugin i dhënë për mediat e atjeshme, se "këtu fillon fundi i hegjemonisë amerikane". Dugin është vizitor i shpeshtë i Ballkanit, por nuk është një turist i zakonshëm që shquhet për pjesëmarrje në ekspozita të tilla. Ai nuk është thjesht një intelektual rus që ka shkruar disa libra për politikën ndërkombëtare dhe hapësirën ish-sovjetike. Dugin është shumë më shumë se aq! Aleksandër Dugin është një filozof fashist dhe si strateg gjeopolitik i Kremlinit, ka qëndruar disa herë në Ballkan. Më 2018 ai prezantoi në Beograd librin e tij të përkthyer në serbisht "Lufta me rrjete". Po atë vit, në Shkup ai mbajti një fjalim para shumë ultranacionalistëve maqedonas rreth misionit ortodoks të Rosisë në botën sllave. Aty ofronte një perspektivë për Maqedoninë që t'i bashkohet komunitetit euroaziatik me qendër Rusinë dhe kjo do të ishte alternativa ndaj integritetit në BE. Ndër të tjera, ai deklaronte se "Perëndimi është duke rënë së bashku me Bashkimin Evropian". Këtë njeri, me dukjen e një prifti ortodoks dhe bashkëmendimtarët e tij ideologjik rreth portalit "Geopolitica", i gjen kudo ku Rusia ka nxitur konflikte: Në Gjeorgji gjatë konfliktit në Osetinë Jugore më 2008; në Ukrainë gjatë aneksimit të Krimesë më 2014; në Mal të Zi gjatë përpjekjes për puq kundër Milo Gjukanoviçit më 2016. Burimet flasin se disa organizata në veri të Kosovës

dhe OJQ serbe janë nën direktiva apo edhe financohen nga rrethi i tij pansllavist rus - njerëz që kanë pikëpamje të errëta fashiste për Kosovën dhe shtetet perëndimore.

Dy përvjetorët e përmendur më sipër natyrisht që janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Nuk mund të ndodhte në asnjë mënyrë rënia e një muri në mes të Evropës pa rolin e jashtëzakonshëm të NATO-së gjatë Luftës së Ftohtë. Për të dyja këto ngjarje, u nxor një bilanc mbi arritjet, çfarë shkoi mirë dhe ku është gabuar. Brenda dhe jashtë BE-së është diskutuar shumë mbi rëndësinë e 1989, veçmas në fokus ishin ngjarjet dhe proceset që sollën ndryshimin e madh pas rënies së komunizmit dhe shpërbërjes sovjetike. Por sot shtrohet pyetja ku jemi pas vitit 1989, në një Evropë gjithnjë e më të përçarë politikisht nga populizmi gjithnjë në rritje dhe polarizimi brenda e jashtë? Në shënimin e vitit 30 jubilar, krye tema e njëjtë ishte edhe në Evropën Juglindore, dikur njëra nga zonat e pushtuara dhe kërcënuara drejtpërdrejt nga sovjetikët. Por, një pyetje që nuk u shtrua këtë herë ishte se cila është politika ruse në raport me Ballkanin pas vitit 1989? Ku mund të gabojmë sot në raport me politikën ruse në rajon? Çfarë rreziku përbën Rusia për stabilitetin, sigurinë dhe demokracinë?

Viti 1989 ndryshoi çdo gjë në politikën ndërkombëtare. I dha fund komunizmit dhe Luftës së Ftohtë, përshkallëzoi fillimin e shpërbërjes sovjetike dhe hapi dyert për bashkimin e Gjermanisë. Mbi të gjitha, ShBA u shqua si superfuqia e vetme, duke vendosur supremacinë amerikane dhe udhëhequr botën drejt një procesi të globalizimit, me përfitime për shoqëri në gjeografi të ndryshme. Historianët ofrojnë statistika se mes viteve 1500 deri më 1945 pothuajse çdo dy vjet kishte luftëra në mes shteteve të fuqishme për dominim në Evropë dhe jashtë saj. Ekonomistët llogarisin që në këto shtatë dekada pas vitit 1945, si rezultat i rritjes ekonomike (diku 3.5 GDP) 4 miliardë banorë e tejkaluan varfërinë.

Veçanërisht, pas vitit 1989, rendi botëror i ri që lindi ishte një rend amerikan, i bazuar më shumë në parime dhe vlera sesa në logjikën e vjetër të politikës së fuqisë së dominimit

mes kombeve. Njëkohësisht, BE-ja me zgjerimin e saj drejt vendeve ish-komuniste dhe me ngritjen që përjetoj, u bë një fuqi e re rajonale e pazëvendësueshme. BE-ja ishte manifestim i fuqisë së butë që rrezatonte përtej kontinentit të vjetër. Kurse globalisht, një valë e madhe e demokratizimit zëvendësoi komunizmin apo edhe forma të tjera të sistemeve politike të mbyllura duke vendosur demokracinë dhe ekonominë e tregut. Ishte fitorja më e madhe e liberalizimit.

Ky ndryshim përfshiu edhe Ballkanin. Formimi i shteteve të reja u mundësoi shumë kombeve jetësimin e idealeve të pavarësisë së tyre. Ngritja e Amerikës dhe BE-së mundësoi edhe ngritjen e Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Kosovës së pavarur. Një vështrim në hartë tregon që më shumë se gjysma e Evropës Juglindore është pjesë e BE-së dhe shumë shtete janë anëtare të NATO-së. Anëtarësimi para dy vitesh i Malit të Zi në NATO dhe këtë vit i Maqedonisë së Veriut janë lajmet më të mira. Pas anëtarësimit të Kroacisë në BE më 2013, vende të ndryshme të Ballkanit janë në faza të ndryshme të integritetit, me lëvizje përpara apo edhe ngecje. Arsyet janë të shumta duke nisur nga fakti që BE-ja apo shtetet anëtare si Franca janë të papërgjegjshme apo edhe për shkak të mos përmblidhjes së shumë kriterëve të vëna evropiane nga ana e vendeve ballkanike. Në këtë frymë, Kosova vazhdon të mbahet në geto pa ndonjë shpjegim serioz për mos liberalizimin e vizave. Pas vitit 1989, ndodhi jo vetëm jetësimi i lirive të popujve, por edhe lirive individuale. Jeta ndryshoi në Ballkan sa i takon punësimin, rritjes ekonomike dhe kohezionit social. Megjithatë, të gjitha vendet ballkanike në shumë fusha të jetës ofrojnë shërbime të standardit të ulët dhe GDP për kokë të banorit është shumë e ulët në krahasim me BE. Kjo është një tregues se vendeve të mbetura jashtë BE-së do t'iu duhen edhe dy dekada për ta arritur atë nivel të GDP për t'u bërë pjesë e BE-së. Një gjë e tillë u pasqyrua para pak kohësh në një raport i Bankës Botërore. Sidoqoftë, popujt e Ballkanit asnjëherë nuk kanë jetuar më mirë historikisht, sesa në dy dekadat e fundit.

Disa e kanë quajtur 1989 si një

vit të madh. Të tjerët kanë folur në vitet 90-ta për fundin e historisë, meqë me këtë ndryshim global - me përhapjen e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe ekonomisë së tregut - historia ka përmblidhur qëllimin e saj. Sot ka një diskurs të ri për rikthimin e historisë. As fundi e as rikthimi i historisë nuk janë parametra serioz për një qasje strategjike apo veprim politik. Më serioze dhe shqetësuese është përpjekja e Rosisë për të rikthyer ndikimin e saj në një formë të re dhe me metoda komplekse në Ballkan.

Për një kohë ka ekzistuar një bindje se rajoni po transformohej plotësisht dhe se ambicia për rivalitet i takon të kaluarës. Mirëpo, veprimet e Rosisë sot flasin për të kundërtën. Kjo nuk është thjesht një përplasje e interesave siç argumentohet herë pas here në Moskë. As nuk është fjala thjesht për manifestim të rritjes së ndikimit. Mirëpo, ka një rikthim të gjeopolitikës, gjeoekonomisë dhe gjeokulturës në një formë dhe intensitet që para disa vitesh ishte përtej imagjinatës.

Rusia historikisht ka pasur interesa në Ballkan. Madje, rivaliteti ruso-perëndimor ishte ndër më të mëdhatë në këtë rajon. Mirëpo, sot përmes narracionit të "vëllazërisë sllave" ideologë rusë promovojnë ringjalljen e saj. Libra dhe shkrime janë botuar kohëve të fundit në qendra të rajonit rreth rolit historik rus në formësimin e fatit të popujve sllavë. Fokus është edhe tek lidhjet e veçanta etno-kulturore, dhe gjoja përputhshmëria e interesave gjeopolitikë të disa vendeve ballkanike me Rusinë. Është një përpjekje për ta rikthyer një perceptim të vjetër historie që gjoja këta popuj janë zgjatje e sferës ruse e ortodokse; që ata janë pjesë e misionit të madh ortodoks.

Vizita të tilla si ajo e Dugin, ngjarje dhe veprime të tjera të padukshme janë pjesë të asaj që njihet si luftë informative. Ajo ka të bëjë me manipulimin e opinionit publik, dezinformimin, lajmet e rreme, manipulimin e rrjeteve sociale dhe shumë qasje të tjera manipulative. Kjo veprimtari është pjesë e diçkaje më të madhe si një lloj "luftë jolineare dhe asimetrike" e mbështetur nga struktura shtetërore për t'u shërbyer interesave strategjike ruse. Sidoqoftë, këto struktura shtetërore asnjëherë nuk asocohen publikisht me ngjarje

apo veprime të tilla dhe mohojnë qëllimet e vërteta. Sot Rusia zbaton në rajon një politikë komplekse për ndikim, duke investuar kohë, energji dhe burime të ndryshme. Përtej këtij rreziku të vazhdueshëm, natyrisht nuk mund të ndodhë një rikthim i agresionit rus në Ballkan në mënyrën se si ndodhi në Gjeorgji apo Ukrainë përmes pushtimit të territoreve dhe duke shkelur rregullat ndërkombëtare. Por, çështja është si të parandalohet Rusia sot, e cila duke projektuar statusin e një fuqie mundohet të arrijë të imponojë ndikim shumëdimensional në rajon.

Lajmet e rreme janë vetëm shfaqja më e gërditshme e luftës informative, ndërsa Alexander Dugin është vetëm një lloj "ambasadori i kërcënimeve hibride". Ai dhe rusët e tjerë të këtij soji duan që ta kthejnë prapa historinë. Qëllimi i tyre është përmblidhja e botës pas 1989, i demokracisë liberale dhe rendit aktual botëror. Këto kërcënime hibride kanë të bëjnë edhe me metoda dhe instrumente të shumta si: presioni politik, shoqëror e deri te ai ekonomik. Rusia është po aq brutale duke përdorur edhe instrumentet e tjera për ndikimet mbi rajonin përmes atyre politike, diplomatike, ekonomike, energjetike dhe ushtarake. Të tilla instrumente dhe metoda nuk janë të pakëta.

Në këtë kontekst shumëdimensional, Serbia dhe Republika Srpska në Bosnjë janë zgjatje e Rosisë. Ato dhe vendet e tjera pro-ruse janë platformat më të mira për të zgjeruar metodat e luftës hibride të fqinjët e tyre. Në rrafshin bilateral, përmes marrëveshjeve të arritura dhe përmes organizatave ndërkombëtare, Rusia synon t'i vendosë shtetet e rajonit në një ndërvarësi politike. Nëse aspekti kulturor përpiket të ndikojë në botëkuptimet e njerëzve, aspekti politik i ndikimit ka të bëjë me atë se a mund të përdoren shtetet e caktuara në rajon si figura të shahut në lojë e saj gjeopolitike. Këtu interesi kyç rus është të ngadalësojë dhe bllokojë anëtarësimin e pjesës së mbetur të rajonit në strukturat euroatlantike. Shembujt e Malit të Zi në tetor të vitit 2016 dhe të Maqedonisë në muajin prill të vitit 2017 me disa përpjekje hibride, pjesërisht të dhunshme, ende janë të freskëta në kujtesën tonë. (Vijon)

Vihet gurthemeli i QMF-së në Gjonaj të Prizrenit

PRIZREN, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Visar Shehu, kanë vënë gurthemelin

për ndërtimin e Qendrës së re të Mjekësisë Familjare në fshatin Gjonaj. Objekti i ri do të jetë dy kate, me sipërfaqe prej 500 m² dhe do ta zëvendësojë atë të

mëparshmin, i cili ka qenë i ndërtuar në vitet '80. "Deri në përfundim të punimeve, që parashihet të zgjasin rreth shtatë muaj, banorët e këtij fshati dhe

zonave përreth do t'i kryejnë të gjitha shërbimet shëndetësore në Ambulanten e Mjekësisë Familjare në fshatin Krajk", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Drenasi përfiton një donacion me komposterë shtëpiakë dhe kontejnerë

DRENAS, 18 DHJETOR (ER) - Komuna e Drenasit, me mbështetjen e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Gjerman (GIZ), në kuadër të projektit për ndarjen e mbeturinave në burim, ka shtrirë edhe sistemin për kompostim dhe ka përfituar një donacion prej 326 komposterësh shtëpiakë si dhe 100 kontejnerë me kapacitet 240 litra të cilët do të shërbejnë për ndarjen e mbeturinave organike nëpër ekonomitë familjare në

zonat e caktuara sipas pilotprojektit.

Përmes këtij projekti do të sigurohen parakushtet për ekonomitë familjare për ndarjen e mbeturinave organike përmes ofrimit të komposterëve. "Nga ky projekt priten shumë përfitime duke filluar nga zvogëlimi i kostos së deponimit të mbeturinave përmes reduktimit të sasisë së mbeturinave që bartën në deponitë regionale, profit

ekonomik familjar për prodhimin e plehut organik. Kjo do të ndikojë edhe në ngritjen e vetëdijes së komunitetit për rëndësinë e trajtimit të mbetjeve si resurs për përfitim", ka njoftuar Komuna e Drenasit. Sipas këtij njoftimi, kjo komunë mbetet e përkushtuar për zbatimin e sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave përmes "3R" (redukto, ripërdor, riciklo), duke përdorur praktikat më të avancuara për këtë qëllim.



Gjilani përmbyll vitin 2019 me projektin e digjitalizimit të arkivit të komunës



GJILAN, 18 DHJETOR (ER) - Drejtorja e Administratës së Përgjithshme në Gjilan këtë vit po e përmbyll me fillimin e projektit të rëndësishëm, digjitalizimin e arkivit të kësaj komune, që fillimisht përfshinë tri drejtori: Administratën, Urbanizmin dhe Kadastrën. Kështu ka bërë me dije drejtori i kësaj drejtorie, Bardhyl Syla, në një konferencë për medie. "Projekti i digjitalizimit të arkivit mundëson qasje të shpejtë dhe më të lehtë të qytetarëve në kërkesat e tyre arkivore, njëkohësisht është i mirëpritur edhe nga zyrtarët e komunës gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të tyre", ka thënë Syla. Duke folur për punën njëvjeçare, i pari i Administratës në Gjilan ka konfirmuar se Qendra për

Shërbime të Qytetarëve ka qenë mjaft efikase dhe funksionale, pasi janë pranuar 152 375 kërkesa nga palët, adresuar organeve komunale për shqyrtim dhe vendosje. Janë përfunduar 146 402 lëndë, kurse në proces janë 4 375 lëndë. "Falë punës së stafit të përkushtuar është arritur objektivi i synuar për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile", ka thënë Syla. Ai ka njoftuar se janë bërë përgatitjet edhe për fillimin e ndërtimit të Zyrës së Gjendjes Civile në lagjen "Arbëria", e cila pritet të finalizohet në vitin 2020. Ndërsa duke folur për E-Kioskat, ai ka thënë se tashmë Komuna e Gjilanit ka siguruar kontratë me operatorin ekonomik për rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Bahtiri nënshkruan marrëveshje me 'Interplast Group'

MITROVICË, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtoresha për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi, kanë pritur në një takim drejtorin e "Interplast Group" në Mitrovicë, Bekim Gashi, me ç'rast kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi mes tyre. Qëllimi i

kësaj marrëveshje është ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i bashkëpunimit të ndërsjellë mes palëve, me fokus të veçantë në fushën e përfituesve të familjeve me skemë sociale në Komunën e Mitrovicës. Përmes kësaj marrëveshje Komuna e Mitrovicës, përkatësisht Drejtoria për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Qendra për

Punë Sociale dhe "Interplast Group" në Mitrovicë, do t'u mundësojnë familjeve me skemë sociale 10 për qind zbritje në të gjitha produktet elektro-shtëpiake. Me këtë rast, kryetari Bahtiri është shprehur falënderues ndaj drejtorit Gashi për bashkëpunimin e treguar për t'i ndihmuar familjet në nevojë në Komunën e Mitrovicës.



Vazhdon asfaltimi i parkingjeve në Skenderaj

SKENDERAJ, 18 DHJETOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se është duke vazhduar projekti infrastrukturor në këtë komunë

për asfaltimin e parkingjeve brenda zonës urbane në qytet. "Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës rrugore është

duke vazhduar projekti për asfaltimin e parkingjeve brenda zonës urbane në qytet. Banorët që jetojnë në këto banesa tashmë do të

kenë qasje infrastrukturore më të mirë dhe më moderne në këtë zonë urbanistike", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.



Lluka ndan mirënjohje për kontributdhënësit në sektorin minerar

PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Për t'i nderuar për kontributin e dhënë në sektorin minerar, ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Valdrin Lluka, ka ndarë mirënjohje për personalitetet e këtij sektori që kanë kontribuar si në sferën akademike, po ashtu edhe në atë sektoriale.

Gjatë fjalimit të ceremonisë së shpërndarjeve të mirënjohjeve, ministri Lluka falënderoi pjesë-

marrësit dhe tha se kontributi i tyre ka qenë faktor për zhvillim të vendit. "Dua ta shfrytëzoj rastin që t'ju falënderoj dhe t'ju tregoj që ju jam mirënjohës për kontributin tuaj të dhënë për sektorin minerar ndër vite. Ju, me kontributin tuaj, qoftë akademik apo ekonomik, kenë avancuar edhe më tutje këtë sektor", ka thënë ministri Lluka.

Ministri Lluka dha mirënjohje

edhe për ish-drejtorët e përgjithshëm të kombinatit "Trepça", të cilët vepruan në formën më të mirë të mundur duke kuptuar kushtet e vështira që kishin.

Gjatë këtij takimi u përkujtuan dhe u ndanë mirënjohje edhe për kontributdhënësit të cilët nuk janë më me ne. "Përmes këtyre mirënjohjeve, dua që emri juaj dhe i atyre që nuk janë në mesin

tonë të mbetet pjesë e historisë së sektorit minerar, për kontributin e dhënë gjatë viteve '70, '80 dhe '90, pa përjashtuar periudhën e pas luftës", ka thënë Lluka gjatë takimit me të pranishmit.

Kjo është lista e personave të cilëve u është dhënë mirënjohja për kontributin në sektorin minerar: Luljeta Pula Beqiri, Ekrem Beqiri, Minir Dushi, Veli Deva, Xhelal Orana, Reshat

Abrashi, Jakup Nushi, Nuhi Preteni, Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, Ibush Jonuzi, Vahdet Pruthi, Hashim Këpuska, Shyqeri Kelemendi, Sefedin Kastrati, Bajram Shabani, Dukaxhin Shala, Hamid Nuredini, Shaip Latifi, Shkelzen Domi, Nazmi Mikolovci, Avni Dushi, Fatmir Rizvanolli, Engjull Mazreku, Unberto Bytyqi, Naip Zeka, Shefki Isufi, Jusuf Vula.



KRU 'Prishtina' kërkon nga konsumatorët t'i paguajnë borxhet



PRISHTINË, 19 DHJETOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" u ka bërë thirrje konsumatorëve në zonën e shërbimit, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Drenas dhe Graçanicë, që brenda 10 ditësh, duke filluar nga e mërkura, t'i përmbyllin obligimet e tyre financiare për shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit për vitin 2019, me theks të veçantë sektori i amvisërisë dhe bizneseve të

vogla e të mëdha.

Sipas kësaj kompanie, konsumatorët kanë obligim ligjor që t'i paguajnë faturat si dhe borxhin e akumuluar të ujit të shpenzuar. "KRU 'Prishtina' falënderon të gjithë konsumatorët për pagesa të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe fton urgjentisht secilin prej tyre, që të jenë sa më të rregullt në pagesa, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'u shmangen ndëshkimeve të kompanisë,

gjegjësisht ekipeve të shqyrcjes dhe procesimit të lëndëve të përmbaruesit privatë. Po ashtu, kompania iu ka ofruar bashkëpunim dhe lehtësira të ndryshme për pagesën e borxheve të mëdha të akumuluar (pagesë me këste mujore prej 12 deri në 36 muaj varësisht nga borxhi i tërësishëm), mirëpo shumë nga konsumatorët kanë refuzuar bashkëpunimin me kompaninë", thuhet në njoftimin e kësaj kompanie.

Dogana pranon donacion 12 000 euro nga qeveria amerikane

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Dogana e Kosovës e ka pranuar të mërkurën një donacion në vlerë prej 12 000 eurove për pajisje për

zbatim të ligjit nga qeveria amerikane. Donacionin e ka pranuar drejtori i përgjithshëm Bahri Berisha nga programi EXBS

i ShBA-së. Përfaqësuesi Rick Clark ka dorëzuar pajisje të Dogana e Kosovës, po ashtu edhe për policinë kufitare. Deri më tani

Dogana ka pranuar rreth 400 000 mijë dollarë pajisje dhe trajnime të financuara nga qeveria amerikane.



Vettingu duhet të nisët nga Prizreni



Shkruan: Gent GJINI

Sot procesi i vettingut është domosdoshmëri e kohës si rezultat i rrethanave të padëshiruara dhe të krijuara në sistemin e drejtësisë. Prandaj, ky mekanizëm duhet patjetër të instalohet nga legjislatura e re duke u rregulluar me ligj të veçantë me (ndryshim plotësimit të Kushtetutës), me qëllim të krijimit të mekanizmave për ta filtruar sistemin e (pa)drejtësisë në Kosovë, ku si qëllim ka pastrimin e sistemit nga korrupsioni, nepotizmi, klanet, nga etika e munguar, profesionalizmi dhe rezultatet e padëshiruara dhe të dobëta që ka prodhuar sistemi i drejtësisë nga kjo çfarë kemi tani.

Në parim, duke qenë të vetëdijshëm që i tërë sistemi i drejtësisë është i ngecur, si në gjykata dhe në prokuroritë e Kosovës, pa dyshim se vettingu duhet të fillojë me Prizrenin. Në sistemin e drejtësisë në Prizren kanë ndodhur gjëra të shumta të cilat në një formë apo në tjetrën e

rrumbullakojnë padrejtësinë në mënyrë më virtuale, me të drejtë-përdrejtë në raport me dukuritë negative që ka ajo sot. Për të argumentuar këtë konstatim do t'i përshkruaj disa nga veçoritë e saj: Në vitin që lamë pas misioni i USAID-it në bashkëpunim me OJQ-në "Demokracia +" kanë prezantuar hulumtimin rreth transparencës dhe efikasitetit të gjykatave themelore të Kosovës, e cila përmban rezultatet e anketave rreth kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e gjykatave sipas vlerësimit të avokatëve.

Nga gjetjet e këtij raporti, Gjykata Themelore në Prizren është ranguar si më e korruptuara. Tani duke i kuptuar këto rezultate të cilat janë të mbledhura në mënyrë të fakteve dhe provave, si dhe nga një mision reprezentativ i rangut botëror që si rol ka monitorimin dhe fuqizimin e drejtësisë nëpër gjykata si ajo e USAID-it, ky hulumtim ka konstatuar se Gjykata e Prizrenit shpallet kampione e korrupsionit. Por nga ky rezultat dhe ky konstatim mjaft alarmant çfarë u ndërmor? Kush reagoi? Pra, askush. Gjërat edhe më pas ngelin ato çfarë janë, pa dhënë përgjegjësi dhe llogari ligjore askush, apo që të paktën të dilet me një qëndrim nga zyrtarët e këtij institucioni në mënyrë që të bëhen reforma dhe rikuperohen gjërat, duke filluar me komisionet

apo procedurat disiplinore, po ashtu duke filluar edhe procedurat penale për aktorët ata të cilët kanë kontribuar në këtë çështje. Dukuri tjetër negative e cila kërkon ndërhyrjen imediate të vettingut në sistemin e drejtësisë në Prizren, është edhe dukuria e nepotizimit, përkatësisht familjarizimit, që janë të punësuar në këtë gjykatë, duke mos përjashtuar edhe institucionin e prokurorisë. Si dukuri apo fenomen që shihet shumë normale në qytetin e Prizrenit. Pra, edhe kjo dukuri lidhur me nepotizmin është argumentuar edhe në emisionin e "Insajderit" "Drejtësia në rrjetin e merimangës", e cila shumë bukur tregon mënyrën e rekrutimeve të punësimit të vlerësuar jo mbi baza të meritës dhe profesionalitetit, por nga bazat dhe lidhjet familjare. Përkundër kësaj, kush mori mësim nga kjo? Askush. Kush reagoi, askush?

Ndërkaq Agjencia Antikorrupsion çfarë bën? A mund të më shpjegojë dikush? Kur punësimet në këtë gjykatë dhe prokuroritë shumica janë (puro familjare) dhe me konflikte të hapura të interesit. Aq më shqetësuese situata bëhet se nga mungesa e rezultateve për mosreagim të luftimit të këtij fenomeni, dukuritë si këto normalisht se më pastaj bëhen inkurajuese dhe shndërrohen në

praktikë të heshtur e të pranuar si vazhdimësi e të ashtuquajturës (punësime familjare).

Misioni i vettingut patjetër duhet të instalohet sepse, përveç të tjerash, këtu duhet të shikohet edhe ana profesionale e njohurive dhe ajo e etikës për t'u kuptuar se si janë bërë disa individë gjyqtarë dhe prokurorë. Sot shoqëritë civile janë monitoruesit që në vazhdimësi kanë kritikuar dhe vazhdojnë ta kritikojnë mënyrën e rekrutimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, të pranuar mbi baza të klaneve, politikës dhe familjarizimit.

E tani përderisa OJQ-të shprehin hapur këtë shqetësim fare lehtë dhe me logjikë të thjeshtë, mund ta kuptojmë se deri ku ka arritur të shtrihet, përkatësisht depërtuar nepotizmi (me të njohshëm) për t'u bërë gjyqtarë e prokurorë, dhe tani për çfarë profesionalizmi mund të flasim.

Sot jemi dëshmitar që lëndët civile nuk caktohen dhe nuk zgjidhen në kohë të arsyeshme, ato mbeten në sirtarë të pluhurosuar. E në anën tjetër, jemi dëshmitar se sot gjyqtarët dhe prokurorët janë më të privilegjuarit sa i përket marrjes së pagave me rritje 100 për qind. Pra edhe kjo dukuri vlerësohet absurde. Pagat janë rritur, gjyqtarët janë shtuar, ndërsa lëndët mbeten të pazgjidhura dhe të harruara. Në veçanti kur është fjala për ata


qytetarë të shkrëtë të cilët mbajnë shpresën në ato lëndë që drejtësia të vendos në kohë të arsyeshme, konform rrethanave të kohës dhe nevojave urgjente të cilat kërkohen.

Vettingu përveç tjerash duhet të jetë mekanizëm që duhet të sheh edhe pasurinë e fituar se sa ato përputhen me standardin e pagës që marrin sot gjyqtarët dhe prokurorët. Të kërkoj prejardhjen e pasurisë së fituar dhe në çfarë mënyre ajo pasuri është fituar dhe sa prej pasurive janë të deklaruara në Agjencinë Antikorrupsion. Edhe kjo është një sfidë që sot e pengon sistemin e drejtësisë.

Këto janë disa prej arsyeve të cilat e karakterizojnë sistemin e drejtësisë në Prizren. Pra, vettingu duhet të fillohet me padrejtësitë nga Prizreni në mënyrë që dukuritë si të lartpërmendurat të largohen. Duke filluar nga shkarkimet e të punësuarve mbi baza familjare, klanore dhe shkarkimet për të korruptuarit. Po ashtu, paralelisht me këto të fillohen edhe inicimet e procedurave penale dhe konfiskimet e pasurive, për ata që kanë degdisur dhe që e kanë sjell në këtë derexhe sistemin e drejtësisë. Për ne mjafton ta shikojmë vettingun si ajo në shtetin e Shqipërisë që padyshim ka shënuar dhe vazhdon të shënojë progres të madh prioritar.

Tërnavava takon ambasadorin turk, falënderon Turqinë për ndihmën që po i jep Kosovës

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Myftiu Naïm ef. Tërnavava, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Prishtinë, Çağrı Sakar. Me këtë rast, myftiu Tërnavava i ka dëshiruar mirëseardhje ambasadorit Sakar dhe ka falënderuar për vizitën duke e njohur me organizimin e BI-së së Kosovës. Myftiu Tërnavava e ka falënderuar, përmes ambasadorit Sakar, Republikën e Turqisë për ndihmën që i ka dhënë Kosovës gjatë dhe pas luftës si dhe për lobimin që bën Turqia që shteti ynë të njihet edhe më shumë në skenën ndërkombëtare si dhe për integrimin e Kosovës në mekanizma rajonale dhe në ata ndërkombëtarë. Ai më pas edhe një herë ka shprehur qëndrimin dhe angazhimin që ka BIK-u që Kosova të jetë një vend i qetë, ku të gjitha komunitetet fetare të jetojnë në paqe, dashuri dhe me respekt të ndërsjellë "Ne shprehim konsideratën tonë ndaj Republikës së Turqisë për përkrahjen që i ka dhënë



Kosovës gjatë ngjarjeve më të rëndësishme për lirinë dhe për shtetndërtimin e saj", ka thënë Tërnavava. Ai ka vlerësuar lart bashkëpunimin me shtetin mik të Turqisë, duke theksuar ndih-

mën në shumë fusha si në jetën ekonomike, kulturore, sociale, edukative dhe për këtë ndihet falënderues dhe mirënjohës për popullin dhe për qeverinë turke.

Nga ana e tij, ambasadori turk Çağrı Sakar ka falënderuar myftiun Tërnavava për pritjen dhe ka premtuar se Turqia si një vend mik dhe aleat i fuqishëm i Kosovës do të vazhdojë të ndih-

mojë në projekte në të dobi të qytetarëve të Kosovës dhe do të angazhohet edhe më fuqishëm për integrimin e Kosovës në mekanizma rajonale dhe në ata globalë.

Diplomati Taylor largohet pas dëshmime në hetimet rreth Trumpit

UASHINGTON, 18 DHJETOR - Diplomati amerikan në Ukrainë, William Taylor, do të largohet nga pozita që nga muaji i ardhshëm, pas një mandati të shkurtër, të përcjellë nga hetimet për shkarkim të presidentit amerikan Donald Trump. Në një shkresë të nisur të përditshmes, "The New York Times", përmes postës elektronike, Taylor ka thënë se do të largohet nga pozita që ka në muajin janar, sepse mandati i mveshur përkohësisht në Ukrainë në muajin qershor, do të skadojë në janar. Administrata e Trumpit do të

"nominojë një ambasador me mandat të plotë shumë shpejt", ka thënë ai, pa dhënë detaje. Më herët, mediat kanë cituar zyrtarë të pidentifikuar amerikanë të kenë thënë se Taylor, i ngarkuar me punë në Ambasadën e Kievit, do të largohet nga pozita që ka në fund të muajit, apo në fillim të janarit. Sipas agjencisë së lajmeve, "The Associated Press", ai do të zëvendësohet nga zëvendësja e tij aktuale, Kristina Kvien. Dëshmia e Taylorit para Komitetit për Inteligjencë të Dhomës së Përfaqësuesve mua-

jin e kaluar, ka ndihmuar në krijimin e rastit kundër Trumpit, i cili akuzohet se i ka bërë presion presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy për të hetuar kundërshtarin e tij politik, Joe Biden, duke ndalur ndihmën ushtarake për këtë shtet. Diplomati e ka konsideruar "çmenduri", mbajtjen e ndihmës ushtarake për Ukrainën, e cila i duhet për të luftuar forcat e mbështetura nga Rusia në provincat lindore. Taylor është dërguar në Ukrainë, pasi Departamenti Amerikan i Shtetit pati dërguar ftesë të



papritur për ambasadorin amerikan në Ukrainë në periudhën 2006-2009. Ai më parë ka shërbyer si

Demokratët të vendosur për shkarkimin e presidentit Trump

Shumica demokrate e ka të sigurt votën përfundimtare për dy akuza për shkarkimin e presidentit Trump, çfarë do të pasojë me një gjykim në Senatin amerikan në fillim të vitit që vjen. Historikisht proceset për shkarkimin e presidentit e kanë përçarë vendin



UASHINGTON, 18 TETOR - Demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve janë një hap larg miratimit të procedurave përfundimtare për shkarkimin e presidentit Donald Trump. Pas debatesh të gjata dhe polemikash të ndara në vija partiake, Komisioni Juridik miratoi të premten ngritjen e akuzave zyrtare ku pretendohet se Trumpi abuzoi me pushtetin dhe pengoi Kongresin për ta hetuar atë, ka njoftuar voa. Donald Trumpi pritet të bëhet presidenti i tretë amerikan ndaj të cilit janë hapur procedura për shkarkim. Presidenti e ka kritikuar procesin. "Përdorimi i pushtetit për shkarkimin është turp për këtë vend", tha ai. Shumica demokrate e ka të sigurt votën përfundimtare për dy akuza për shkarkimin e presidentit, çfarë do të pasojë me një gjykim në Senatin amerikan në fillim të vitit që vjen.

Para hapit përfundimtar të votimit në Dhomën e Përfaqësuesve, ligjvënësit demokrate argumentuan se presidenti Trump duhet larguar nga detyra pasi përdori ndihmën për Ukrainën për interesat e tij personale politike. "Cili është rreziku nëse nuk veprojmë? Gjatë 94 ditëve që nga fillimi i hetimeve nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe realisht gjatë tre viteve të shkuara, një e vërtetë e padiskutueshme ka dalë: nëse nuk reagojmë ndaj abuzimit të pushtetit nga presidenti Trump, abuzimi do të vazhdojë. Nuk mund të mbështetemi te zgjedhjet për të zgjidhur problemin tonë kur presidenti Trump kërcënon vetë integritetin e zgjedhjeve", tha demokrati Jerrold Nadler, kryetar i Komisionit Juridik në Dhomën e Përfaqësuesve. Nga ana tjetër, republikanët argumentojnë se telefonata e

presidentit me homologun ukrainas Volodymyr Zelenskiy ishte përpjekje për të trajtuar korrupsionin në Ukrainë dhe jo për avantazhe politike në Amerikë. Ata këmbëngulin se demokratët gjatë gjithë kohës kishin në mendje shkarkimin e Trumpit. "Ata paracaktuan se do ta bënin dhe e bënë pavarësisht çdo gjëje. Ata nuk kishin asnjë provë, asnjë fakt por gjithsesi vepruan në të tyren. Ata po e coptojnë këtë vend", tha Debbie Lesko, ligjvënëse republikane. Historikisht proceset për shkarkimin e presidentit e kanë përçarë vendin. Ndërsa pothuajse gjysma e vendit mbështet

procesin ndaj Trumpit, demokratët argumentojnë se opinioni publik është në anën e tyre. "Publiku mendon se ata duhet të vendosin se kush është presidenti i Shteteve të Bashkuara dhe jo ndonjë fuqi e huaj. Ata mendojnë se askush nuk është mbi ligjin dhe ne mendojmë kështu. Presidenti duhet të mbahet përgjegjës për abuzim pushteti dhe pengim të Kongresit", tha Nancy Pelosi, kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve. Edhe pse gjyqi në Senatin e kontrolluar nga republikanët pritet ta shfaqë Trumpin, duke e mbajtur atë në detyrë,

republikanët thonë se procesi i shkarkimit do të ketë pasojë mbarëbotërore për diplomacinë amerikane. "Presidentit iu desh të publikonte për mbarë botën përmbajtjen e telefonatës. Kjo e ka dobësuar zyrën e presidentit, për këdo që vjen më pas. Cili udhëheqës botëror do të ndajë me presidentin amerikan qëndrime të vërteta dhe mirëkuptim dhe të mos frikësohet se biseda e tyre telefonike do të publikohet për tërë botën?", tha Kevin McCarthy, udhëheqës i pakicës republikane në Dhomën e Përfaqësuesve. Ligjvënësit po i afrohen me shpejtësi një momenti të rallë në historinë politike të SHBA-së.

Anulohet shfaqja e fishekzjarrëve në Hong Kong

HONG KONG, 18 DHJETOR - Qyteti gjysmëautonom i Hong Kongut njihet për shfaqjet e mrekullueshme të fishekzjarrëve natën e Vitit të Ri. Spektakli çdo vit ka tërhequr një numër të madh turistësh, por tradita do të thyhet sivjet. Hong Kongu po përballet me një situatë të paqëndrueshme prej gjashtë muajsh, me protestat që fillimisht kishin si kërkesë anulimin e një ligji ekstradimesh. Tani protestuesit kërkojnë më shumë liri dhe demokraci. Pikërisht për shkaqe sigurie, u mor vendimi që shfaqja e fishekz-

jarëve për vitin 2020 të anulohet. Viti 2020 nuk do ta gjejë të ndriçuar me fishekzjarrë qiellin mbi Hong Kong. Qyteti që njihet për spektaklin e mrekullueshëm të fishekzjarrëve anuloi shfaqjen kryesore të ceremonisë së pritjes së Vitit të Ri. Vendimi u tha se u mor për shkaqe sigurie, pasi prej gjashtë muajsh Hong Kongu ndodhet në një situatë të paqëndrueshme nga protestat që filluan kundër një ligji ekstradimesh, demonstrata që po vazhdojnë me kërkesën për më shumë liri dhe

demokraci. Anulimi i spektaklit të shumëpritur, më së shumti preku vizitorët të cilët shprehen të zhgënjyer, ndonëse e kuptojnë situatën. "Si turist jam paksa i mërzitur sepse njerëzit presin të festojnë, por e kuptoj vendimin. Nëse është në pyetje siguria e banorëve, nuk ka problem. Më mirë të shtyhet ose anulohet", thotë Jose Gadin, turist nga Filipinet. Çdo 31 janar porti Victoria mbushet me banorë dhe turistë nga mbarë bota. Numërimi mbrapsht deri në fillimin e vitit të



ri, transmetohet në mbarë botën. Por protestat në ish-koloninë britanike shkatërruan ekonominë dhe tregtinë, pasi muajt e fundit shumë ngjarje kulturore e sportive janë anuluar.

Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (10)

MISIONI VERIFIKUES I OSBE-së VIZITON NËNTË USHTARËT E ZËNË PENG NË VENDIN E NGJARJES



LULZIM SAHITI

Pas rënies në pritë të grupit të vëzhguesve të UÇK-së, pjesa dërrmuese e ushtarëve kanë filluar tërheqjen në drejtim të Shqipërisë, të cilët kanë rënë në pritën e dytë serbe. Në këtë rast, krahas ushtarëve të vvarë, 7 janë zënë të gjallë në këtë vend, kurse dy të tjerë nga Rahoveci janë zënë në pozicion tjetër. Në mëngjes ushtarët e zënë i grumbullojnë në një vend, ku ushtarët serbë e ndezin një zjarr përreth të cilit ngroheshin edhe ushtarët e UÇK-së. Aty Xhavit Krasniqi dhe Merita Ramadani, infermiere, ia japin ndihmën e parë ushtarit të plagosur rëndë, Enver Krasniqi. Rreth orës 9:00 në vendin e ngjarjes kanë ardhur përfaqësuesit e Misionit Verifikues të OSBE-së nga Prizreni, të cilët kanë fotografuar trupat e pajetë të luftëtarëve të

UÇK-së, mandej kanë marrë shënime për të dhënat personale të të zënëve rob dhe i fotografojnë ata një nga një. Diku pas gjysmë ore kanë ecur monitoruesit ndërkombëtarë dhe forcat serbe fillojnë kontrollimin e kufomave duke ua marrë të gjitha gjësendet që kishin dhe armatimin e tyre.

Me këtë rast, pas kontrollimit të gjerë të terrenit në zonën e zgjeruar të karakollit "Liken", ushtria armike ka konfiskuar: dhjetëra pushkë automatike, pushkomirolozë, dy pushkë snajperë "Sig Sauer", qindra plumba të kalibrit 7.62 mm, pastaj plumba "Tompson" 11.43 mm, plumba të tromblonit 7.62 mm, plumba vinçester 7.62 mm, plumba 12.7 mm, bomba dore, ndezës për bomba dore, tri radiolidhje "Motorola", dy busulla, një centralë për aktivizim në largësi të eksplozivit, kapsula elektrike për detonim, minahedhës, ndezës për mina në largësi, raketahedhës dore për një përdorim "Zola", disa kg eksploziv tritol, përgatitje tjera ushtarake dhe mjete financiare mbi 250.000 marka gjermane. Në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe fotografi, harta topografike, libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës" (Dokumente dhe artikuj) të përgatitur nga Gafurr Elshani, "Tregime të



Pranë këtij bunkeri ishin tendat Ushtria Jugosllave

zgjedhura amerikane" e të tjera.

Në cilësinë e gazetarit të televizionit publik serb, RTS, Milovan Drecun ka marrë pjesë indirekt në këtë aksion të forcave kriminale serbe. Ai pas përfundimit të të shtënave ka bërë reportazh në këtë zonë duke xhiruar pjesëtarët e rënë

dëshmorë të UÇK-së dhe të të zënëve rob nga Ushtria Jugosllave që ngroheshin pranë një vatre zjarri.

Pastaj, dëshmorët e rënë i fusin nëpër thasë të zi. Rreth orës 21:00 ushtarët e rregullt serbë, prapa shpine ua lidhin duart me pranga pesë ushtarëve të UÇK-së dhe secilin nga ta i detyrojnë duarlidhur t'i tërheqin zvarrë nëpër borë nga dy trupa të pajetë të vendosur në thasë të najlonit dhe prapa secilit ushtarë të UÇK-së shkante nën përcjellje të tyre një ushtar serb. Gjatë tërheqjes së kufomave, çuditërisht Xhavit Krasniqi iu këputën prangat nga duart e përgjakura. Ai menjëherë i ngritë të dy duart lartë dhe pason lidhja e sërishme me pranga tjera. Kështu kanë tërhequr teposhtë së bashku me ushtarët serbë 35 trupat e pajetë të ushtarëve të vvarë dhe dy të plagosurve rëndë në një lokacion tjetër në largësi rreth dy kilometra nga fushëbeteja e përgjakshme.

Në të majtë të këtij vendi të rrafshët kishin qenë të ngritura dy-tri tenda të ushtrisë serbe dhe rrëzë tyre ishte ngritur me gurë një bunker. Mandej, këtu i lanë gati për të vdekur dy të plagosurit, kurse pesë ushtarët e UÇK-së i nisnin këmbë në një udhëtim të gjatë prej dy-tri orëve nën përcjelljen e mbi dyqind ushtarëve serbë të ardhur nga pozicione të ndryshme. Nga fushëbeteja deri në fshatin

Planej ishte 7 kilometra. Në hyrje të fshatit, në të djathtë të rrugës ndalën ushtarët serbë dhe kërkoi ujë për të shuar etjen nga plaku me plis të bardhë, Selim Vorfaj, i cili në oborr kishte një kope të madhe me dele. Maltretime të tilla për banorët lokal në zonën kufitare ishin bërë të zakonshme, natën dhe ditën. Ndërkohë, vazhdojnë rrugën tutje dhe në të majtë të rrugës shihej shkolla e fshatit, që barte emrin "Vëllezërit Frashëri". Dalëngadalë kanë arritur te Karakollit në Planej, ku ishte e vendosur ushtria serbe. Ishte një ndërtesë e ndërtuar krejtësisht nga guri. Këtu në oborin e karakollit, ushtarët e UÇK-së duarlidhur rrahën pa mëshirë nga paramilitarët serbë. Aty nuk qëndrojnë gjatë, i hedhin përmbys njërin mbi tjetrin në automjetin ushtarak "Pinzgauer", kurse mbrapa në përcjellje u shkon "Pinzgauer"-i, tjetër dhe një xhip. Rreth orës 5:00 të mëngjesit mbërrijnë në oborin e ish-Kazermës Ushtarake "Ramiz Sadiku" të Prizrenit, ku takojnë policin famëkeq të Shtimes, Slaviša Marinković, që voziste një autobлиндë. Ai meqë vinte nga Shtimja, ushtarët tanë i kishte njohur dhe filloi t'i quante terroristë. Nuk ka zgatur shumë, menjëherë i dërgojnë në paraburgim brenda objektit të kazermës. Pas pak kohe i sjellin edhe dy ushtarët e Rahovecit. (Vijon)



Rrënojat e Karakollit të Ushtrisë Jugosllave në Planej, pas fushatës ajrore të NATO-s, e njohur si "Forca Aleate e Operacioneve" në vitin 1999




ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Anatomia e një luftëtareje në librin 'Bleibende Spuren'



Lulëzim ETEMAJ

Libri me rrëfime nga jeta e autores Basrie Murati - Sakiri, "Bleibende Spuren", përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë në fokusin kryesor e ka kohën shtator 1988 - maj 1989, ndërsa pjesa e dytë përfshinë një periudhë më të gjatë kohore, duke filluar nga qershori i 1989-s deri më 2019, kur botohet libri, periudhë gjatë së cilës ajo gjendet e mërguar në Zvicër, ku jeton edhe tani.

Në pjesën e parë të librit, autorja është një vajzë e re, 17-18-vjeçare. Është gjimnaziste e vitit të 3-të, dashamirëse e fjalës së bukur. Ajo shkruan edhe vet poezi dhe prozë dhe e udhëheq grupin letrar të shkollës. Greva e minatorëve të "Trepçës", 20-28 shkurt 1989, e nxjerr atë në sipërfaqe, përmes fjalimit përkrahës spontan, që e mbanë një ditë para bashkëmoshatarëve, nxënë të disa klasave, të cilët në shenjë solidarizimi me minatorët kishin refuzuar mbajtjen e mësimin.

Paraprakisht, ajo e përjeton brutalitetin e rrethimit, sjelljes dhe bastisjes me themel të shtëpisë nga forcat serbe në mëngjesin e hershëm të 25 shtatorit të vitit 1988, marrjen e babait nga ta, ndërsa më pastaj edhe burgosjen e vëllait, shkaku i veprimtarisë politike atdhetare.

Në fakt kjo grevë dhe ky fjalim i shkurtër, shënon pikën kulminante të angazhimit të saj konkret politik. Njëkohësisht, po kjo paraqitje i jep jetës së saj të mëpastajme kahe të posaçme të rrjedhës. Sfidat që ia sjell ajo, i kërkojnë shumë guxim, qëndrësë, vetëmohim e sakrificë. Tani e tutje vajza e re e Llapshaticës, e rritur në një rreth e familje patriarkale, ku dominon fjala e babait, nga leximi i librave të ndaluar nga pushteti dhe materialeve tjera të organizatës politike patriotike Lëvizja për Republikën e Kosovës (LPRK), merr mbi supet e saj të njoma një rol tejet aktiv transformues, si në planin social personal ashtu dhe në atë shoqëror dhe politik. Në planin personal, nga një vajzë shqiptare e dëgjueshme, sado që jo krejt pa shenja mospajtimi, porse të ndrydhura në vete, bindëse ndaj autoritetit të babait, ndërmer veprime që bien tërësisht në kundërshtim me sferën ku duhej të dëgjohej fjala e tij vendimmarrëse. E kësaj natyre është shpërndarja e thirrjeve, fshehtas tij, shkaku i frikës se nuk i jepet leja për rrezikime të tilla, dhe po ashtu fshehtas ndjekësit të luftëtarëve për republikën e Kosovës,

pushtetit serb. Pjesëmarrja në demonstratën e 27 marsit 1989 në Besjanë kundër heqjes së dhunshme që Serbia i kishte bërë autonomisë jo të plotë të Kosovës, paraqet veprimin e tillë të radhës. Ky angazhim shoqërohet paraprakisht me prerjen e flokëve, vënien e kapelës në kokë, për qëllime maskimi dhe shpëtimi nga njohja dhe arrestimi që mund t'i bëhej nga forcat serbe, dhe çarjen e mëngjesit të ftohtë me biçikletën e vëllait. Një veprim ky i paimagjnueshëm për dëshmitarët e kohës, njohës të mentalitetit patriarkal dhe situatës së rënduar politike, për t'u kryer nga një femër. Rrethanë ekstra rënduese paraqet qarkullimi i tankeve të ushtrisë serbe, me të cilat ajo ndeshet gjatë aksionit në agim të ditës, e të cilat demonstironin forcën përballë popullatës civile shqiptare nëpër rrugët e fshatrave dhe qyteteve të Kosovës.

Në rrëfimin e saj për këtë kohë, autorja është e hapur dhe e sinqertë, si me veten ashtu dhe me lexuesin. Ajo shkruan për gjendjen dhe përjetimet e saja në mënyrë të detajuar, pa zbulime e krijim figurash kozmetike. E tillë shfaqet edhe atëherë kur e ndjen veten si të ishte me krah dhe i duket se madje edhe mund të fluturojë po të kishte flatra, ndjenjë që e përjeton gjatë shpërndarjes së thirrjes më 27 mars 1989 për demonstratë, pra gjatë kryerjes së detyrës qytetare në shërbim të lirisë së atdheut. E njëjta gjë vlen edhe për momentet kur ka

ndrojtje se si mund të vlerësohet angazhimi i saj politik nga babai. Njëkohësisht e shfaq ndjeshmërinë e saj, deri në derdhje loti, nga goditja e rënd që ia shkakton vrasja në luftim me forcat serbe e bashkëluftëtarit Ali Ajeti.

Gjithsesi, autorja në libër e nxjerr në pah me kujdes të madh edhe ndjenjën e respektit të veçantë dhe mirënjohjes së thellë, që e ndjen për të gjitha ato familje që i ofruan strehim, bukë, veshje e kujdes, "Shqipësi", siç e rimeritojnë shokët e veprimtarisë, dhe bashkëveprimtarëve të saj, gjatë kohës së strehimit të fshehtë tek ta shkaku i ndjekjes së vazhdueshme nga forcat serbe.

Me ndjenjën e respektit më të thellë autorja i portretizon, krahas bashkëluftëtarëve të tjerë, posaçërisht Ahmet Haxhiun, "Bacën", dhe "Syshqiponjën", Fadil Vatën, dy nga heronjtë e heshtur, njëherësh drejtues të lëvizjes çlirimtare të Kosovës. Me ta njihet gjatë qëndrimit fshehtas në "folenë e shqiponjës", siç e quan banesën e Ahmet Haxhiut në Prishtinë, para se të detyrohej, shkaku i ndjekjes, për t'u arratisur fshehtas dhe strehuar në Zvicër. Së bashku me ta do ta përjetoj ndjenjën e gëzimit të madh që ua sjellë shtypja e fletushkës "Minatori" si dhe buletinit të "Zërit të Kosovës", "Rruga e Lirisë".

Në pjesën e dytë të librit "Bleibende Spuren", nga qershori i vitit 1989, autoren e ndeshim në Zvicër, të lënë në udhëkryqin jetësor, nën mëshirën e fatit dhe


sfidave të panumërta. Në rrethana të tilla, krejtësisht të reja, ajo, duke e pas si pjesë të qenies së saj, njëherit dhe anë të fortë, këmbënguljen dhe qëndrësën, vazhdon e vetmuar luftën në vend të huaj për mbijetesë të dinjitetshme. Është e detyruar t'u nënshtrohet procedurave burokratike të azilkërkimit si dhe të kryejë punë shpesh të rënda, në funksion të jetesës së ndershme, nga munda dhe djersa e vet, e shoqëruar jo rrallë nga mosmirënjohja dhe mosvlerësimi adekuat që i bëhet. I përballon që të gjitha. Me gjithë vështirësitë e pengesat që i has në fillim me gjuhën gjermane e reformat e panjohura të arsimimit, mbarimi i shkollimit dhe aftësimi profesional ia kanë hapur rrugën të ketë një karrierë të suksesshme profesionale.

Ajo çfarë e shquan në veçanti autoren edhe në këtë pjesë të jetës në mërgim, është malli brejtës, dashuria e freskët, e ruajtur me xheloz, ndaj familjes, prindërve, vëllezërve, motrave, shoqërisë, por dhe atdheut, Kosovës.

Miqësinë e shëndosh me vendasit e arrin me punë përkushtuese, sjellje korrekte, përpikshmëri, respekt dhe integritet shembullor në shoqërinë zvicerane. Mosheqjen dorë me asnjë kusht dhe për asnjë çmim nga jetësimi i ëndrrave, e shndërron në parim themelor të jetës. Ndërsa këmbëngulja në të drejtën elementare; për trajtim të barabartë, njerëzor dhe të dinjitetshëm, si njeri dhe njëkohësisht edhe si femër, paraqet pikën më të fortë

identifikuese të karakterit të saj prej femreje të guximshme. Rezultat i një përcaktimi të tillë dhe i një filozofie të tillë jetësore, është edhe botimi këtë vit i librit të saj nga Shtëpia Botuese e Zvicrës, njëra ndër më të njohurat, "Rotpunktverlag". Ky është një satisfaksion, një dhuratë simbolike për të gjitha përpjekjet dhe privimet e saja, si në planin e ngushtë personal, ashtu dhe atë universal.

Libri "Bleibende Spuren" ("Gjurmë të përhershme"), është një kronikë e pasur me gjurmë të pashlyeshme, të përzgjedhura me një shije të pasur letrare, të një brezi të caktuar të luftëtarëve idealistë për Republikën e Kosovës. Pjesëtare e këtij brezi është edhe vetë autorja. Si i tillë, libri e pasuron si letërsinë dhe vlerat e saja humane të përgjithshme, ashtu edhe historiografinë, jo vetëm shqiptare, por edhe atë evropiane. Ndërsa lexuesit gjermanofonë ia bën të afërt, përmes tregimit të rrjedhshëm dhe të lehtë, dallimin mes dy kulturave, asaj shqiptare dhe zvicerane. Pas leximit të librit, lexuesi fiton po ashtu një pasqyrim më të qartë mbi luftën këmbëngulëse të femrës shqiptare. Kjo luftë, e zhvilluar në dy fronte; atë familjar, ku përballja zhvillohet me ligjet e pashkruara patriarkale, dhe atë të çlirimit nacional, përballë ndjekjes, shtypjes dhe dhunës së egër të pushtuesit, Serbisë, kurorëzohet me triumf, si qëllim final i ligjshëm i autores, vendit dhe popullit të saj.



Im Sommer 1989 flüchtete Basrie Sakiri-Murati aus dem Kosovo in die Schweiz. Dass sie dreißig Jahre später noch immer hier leben würde, war für die junge Aktivistin undenkbar. Bleibende Spuren ist ein berührender, wohlthuend leiser, zuweilen aber auch wütender Bericht von Flucht und Ankunft. Von einem Leben zwischen zwei Welten, zwei Kulturen.

Basrie Sakiri-Murati
Bleibende Spuren
Mein Weg vom Kosovo in die Schweiz

Bleibende Spuren

Basrie Sakiri-Murati

Rotpunktverlag

Rotpunktverlag

Bisedë me studenten dhe përkthyesen e re bullgare, Magdalena Dimitrova

Studentët e shqipes në Bullgari

Në Universitetin e Sofjes "Shën Klimenti i Ohrit", kurset e para të gjuhës shqipe u organizuan më 1962. Ligjerat u zhvilluan nga atdhetari i shquar korçar, Thoma Kacorri. Ndërsa, në vitin 1994, me themelimin e degës së Ballkanistikës, në Fakultetin e Sllavistikës, arrihet deri te zyrtarizimi i mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe, krahas gjuhëve tjera ballkanike.



Bisedoi: Mimoza Hasani PLLANA

Universiteti i Sofjes "Shën Klimenti i Ohrit", ofron shumë programe për studentët bullgarë dhe të huaj. Nga fusha e letërsisë ofrohen programe të shumta për letërsinë e popujve të Europës, Amerikës, Azisë, Afrikës dhe Australisë, si zgjedhjet të studionit për gjuhën dhe letërsinë shqiptare?

Magdalena Dimitrova: Kur kërkoja çfarë të studioja pas mbarimit të shkollës, ideja kryesore ishte të gjeja diçka që përfshin sa më shumë gjuhë dhe kështu fillova studimet e mia në degën e Ballkanistikës, ku zakonisht mësohet për letërsinë, historinë dhe gjuhët e popujve të Bashkimit Gjuhësor Ballkanik (rumanisht, shqip, greqisht, bullgarisht).

Gjatë studimeve, keni ndjekur kurse të letërsisë krahasimtare, çfarë mendoni se e dallon letërsinë shqipe nga letërsitë e tjera të popujve ballkanikë?

Magdalena Dimitrova: Megjithatë ka shumë motive dhe tema të përbashkëta, ka edhe shumë dallime midis letërsisë shqipe dhe letërsisë së Rumanisë, Bullgarisë dhe të Greqisë. Figurat mitologjike si për shembull Bajlozi, Fierkuja, Syqenëza, temat për trimërinë e Skënderbeut, për çështjet e alfabetit, për bektashinjtë, për mërgimin dhe fakti që veprat vijnë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia Veriore, Mali i Zi dhe nga diaspora shqiptare në SHBA, në Itali etj., që të krijojnë një letërsi të shumanshme – kjo tregon shumë dhe e dallojnë atë nga letërsitë e vendeve të tjera të rajonit.

Si studente jeni e dalluar, sidomos në fushën e përkthimit. Tanimë keni përkthyer disa poezi nga gjuha shqipe në gjuhën bullgare. Si filluat të

merreni me përkthimet e teksteve letrare?

Magdalena Dimitrova: Fillova të merrem me përkthime falë profesorëve të mi në degën e Ballkanistikës, të cilët na kanë ndihmuar në hapat e para dhe vazhdojnë të na ndihmojnë edhe tani. Bënim shumë përkthime bullgarisht-gjuhë ballkanike dhe anasjelltas dhe për shkak të interesit tim gjuhësor e zbulova se sa shumë mund të mësohet për një popull dhe për shpirtin e tij duke përkthyer letërsinë.

Përkthimi letrar vlersohet si një nga disiplinat më sfiduese të letërsisë, si është për ju, si përkthyes e re?

Magdalena Dimitrova: Në fillim ishte shumë e vështirë, kam ende shumë për të mësuar, por kur të fillosh njëherë, fjalët flasin – mund të kapësh ndjenjat, nuancat dhe ta përjetosh veprën – kjo është më e rëndësishmja. E ndjej në zemër dhe nuk kam frikë të përkthej, sepse me vetëdije i bëj sfidë vetes, çdo herë të mësoj diçka të re.

A mund të ndani me lexuesin praktikën tuaj të përkthimit?

Magdalena Dimitrova: Kërkoj



për kuptimin e çdo fjale, që nuk e di dhe nëse akoma kam paqartësi – pyes profesorët, shokët e mi, që të jem e sigurtë se e kam kuptuar mirë.

Bazuar në programin e studimeve, sipas jush cilët janë autorët më emblematicë të letërsisë shqipe, nga klasikët dhe deri sot?

Magdalena Dimitrova: Është shumë e vështirë të zgjedhësh kur çdo autor kontribuon për formimin e identitetit kombëtar dhe për radhitjen e letërsisë shqipe pranë letërsive të mëdha europiane, por do të provoj: Nga letërsia e hershme shqipe – Marin Barleti Nga Romantizmi – Zef Serembe, Jeronim de Rada Nga Rilindja Kombëtare – Vëllezërit

Frashëri, A. Z. Çajupi, Fan Noli, Gjergj Fishta Nga Realizmi – Migjeni Nga Modernizmi – Lasgush Poradeci, Faik Konica Realizmi socialist – Ismail Kadare, Dritëro Agolli Nga Postmodernizmi – Ali Podrimja, Din Mehmeti, Edi Shukriu.

A keni provuar të përktheni autorë bullgarë në gjuhën shqipe?

Magdalena Dimitrova: Po, shumica e gjërave që kam përkthyer ka qenë në formë gojore deri tani, por kam ruajtur dhe përkthimet e disa vjershëve të hedhura në letër – nga Evtim Evtimov i cili është ndër poetët e mi të pëlqyer; nga Dimitër Kallburov – një poet bashkëkohor, dhe disa fragmente të tjera.

A keni pasur rast të përfitoni nga shkëmbimi i përvojave nëpërmjet seminareve dhe konferencave, që organizohen në Kosovë dhe Shqipëri?

Magdalena Dimitrova: Patjetër! Siç thashë dhe më herët, kam ende shumë për të mësuar dhe çdo ditë mësoj nga një fjalë të re dhe njerëzit me të cilët u njoha në Kosovë dhe në Shqipëri. Merren prej shumë vitesh me shqipen dhe duke biseduar me ta, kam mësuar edhe më shumë gjëra të reja, veçanërisht në kurset e shqipes, ku duhet të përqëndrohem mbi tema të ndryshme që kërkojnë terma specifike – kjo më ka ndihmuar shumë në përkthimet që kam bërë.

Para se të filloni studimet, sa keni patur njohuri për gjuhën dhe letërsinë shqipe?

Magdalena Dimitrova: Fatkeqësisht në Bullgari më përpara nuk dihej apo thjesht nuk dëgjohej shumë për

Shqipërinë, aq më pak për letërsinë që botohej. Më vjen shumë mirë që në kohën e fundit gjërat kanë ndryshuar, sepse jemi shumë afër njëri-tjetrit dhe duhet të dimë për popujt përreth nesh, po ashtu edhe për kulturën, gjuhën dhe letërsinë e secilit vend të rajonit. Unë, si shumica e bullgarëve, kisha dëgjuar shumë pak për gjuhën dhe letërsinë shqipe, më tepër përmes këngëve, sepse ishin shumë të përhapura këtu, por jam shumë e lumtur që në Universitetin e Sofjes e pata mundësinë e artë që të gjeja bukurinë e gjuhës shqipe e cila është aq e pasur dhe nuk ka lidhje me asnjë prej gjuhëve të tjera që kam mësuar – kjo e bën shumë të veçantë për mua, që të merrem me gjuhën dhe letërsinë shqipe.

Cilat janë interesimet tuaja për gjuhën shqipe, a do të vazhdoni studimet në nivele më të larta, në funksion të vazhimit të mësimdhënies në Universitetin e Sofjes?

Magdalena Dimitrova: Po, dua të vazhdoj në fushën e gjuhës dhe dua të merrem edhe më shumë me shqipen dhe me gjuhët e tjera ballkanike sepse ka shumë gjëra të fshehura që presin për ne që t'i zbulojmë dhe t'i studiojmë, në të gjitha dimensionet e veta.

Magdalena Dimitrova, është studente në vitin e pestë në degën e Ballkanistikës, në Universitetin e Sofjes, "Shën Klimenti i Ohrit". Ka mbaruar shkollën e gjuhëve anglisht dhe hebraisht dhe ka vazhduar të ndjek interesimet e saj për gjuhët, letërsinë dhe kulturologjinë. Deri tani ka përkthyer disa pjesë nga vepra të autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare. /KultPlus.com



E rrallë

Humbi gjymtyrët në aksident, macja me këmbë protezë fiton zemrat e gjithë njerëzve



Macja e quajtur Vituzzo ka 'shpërthyer' rjetet sociale pasi është e para e cila ka dalë me sukses nga një operacion në dy këmbët e pasme. Ajo u përplas nga një makinë ku dy këmbët e saj të pasme u dëmtuan tërësisht. Disa doktorë italianë

arritën t'i vendosnin dy proteza që do të shërbenin si këmbë dhe i mundësuan që ajo të ecë sërish. Vituzzo u bë e famshme në "Instagram" pasi dy pronarët e saj postonin foto dhe video të maces së tyre duke ecur.

FOTO E DITES



Një majmun shihet brenda një kafazi pasi mbërriti nga Bali, në aeroportin e Indonezisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Një fshat i tërë kthehet në hotel

Një fshat i vogël malor, i mbuluar nga gjelbërimi, ka ndërtesa që kanë mbetur të paprekura për shekuj të tërë, por rrezikonte të kthehej në fshat-fantazmë. Fshati i quajtur Corippo, në kantonin italian të Zvicrës jugore, duket sikur ka dalë nga ndonjë përrallë. Megjithatë, banorët po përballen me një realitet të hidhur. Dikur një komunitet fermerësh me 300 banorë, sot Corippo ka mbetur me vetëm 12, 11 prej të cilëve janë mbi 65 vjeç. Të



vetmet veprimtari ekonomike janë një bujtinë dhe një restorant i vjetruar. Kjo ide është vërtetuar si e suksesshme në Itali dhe mund të vërë në punë 30 nga 70 ndërtesat e fshatit.

BARSOLETA E DITËS



- Çfarë është një parainfarkt?
- Ta futësh dorën në xhep dhe nuk e gjen celularin.
- Po infarkti?
- Kur ta merr telefonin gruaja dhe nuk i ke vënë çelës.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Nuk është se keni arritur të zgjidhni çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjellë më shumë stres se zakonisht.



DEMI

Keni fituar pavarësi morale dhe financiare nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



BINJAKËT

Një detaj që po ju ha shumë kohë dhe po ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni i përkryer dhe do t'ia arrini qëllimit.



GAFORRJA

Keni filluar të keni më shumë besim tek personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



LUANI

Nuk keni shumë kohë për mëdyshje dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm pa asnjë rezervë.



VIRGJËRËSHA

Keni zgjedhur mënyrën më të thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



PESHORJA

Komunikimi është shumë i rëndësishëm sot. Nëse nuk bisedoni si me kolegët, ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



AKREPI

Një person ka krijuar një ide të gabuar për ju që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni mund ta ftoni për një takim.



SHIGJETARI

Keni vënë baza të forta për të ardhmen tuaj profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



BRICJAPI

Duhet t'i mirëkuptoni pjesëtarët e familjes sot që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që dashur pa dashur i kushtëzon edhe ata.



UJORI

Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse ta merrni në dorë situatën dhe të mundoheni t'i zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



PESHQIT

Keni qenë shumë të ndjeshëm ndaj ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrim nisur nga një situatë e caktuar.

"All I want for Christmas Is you" më në fund kryeson klasifikimet amerikane



Kënga festive klasike e Mariah Carey "All I want for Christmas is you", më në fund kryeson në klasifikimet e ShBA-së, 25 vjet pasi u publikua për herë të parë. Ndonëse ishte kënga më e dashur festive të fundvitit, e të të gjitha kohëve kjo këngë nuk arriti kurrë në vendin e

parë në ShBA deri tani. Kur kënga bëri debutimin më 1994, konsiderohej interpretim i gjatë që nuk lejonte atë të garonte në 100 më të mirat në Billboard. Ndryshimet e rregullave panë që kënga së pari të hynte në tabelë në vitin 2000 dhe vitet e fundit ajo ka ngjitur më pranë vendit të parë.

Kate thotë se Williami e impresionoi gjatë studimeve me gatimin e salcës poloneze



William është bashkuar me gruan Kate Middleton dhe Mary Berry në një shfaqje gatimi për Krishtlindje. Programi, i cili do të jetë premierë në BBC One më 16 dhjetor, do ta shfaqë treshen duke gatuar për festë dhe do të vizitojnë një numër të qendrave të bamirësisë. Por,

më parë Princi William kishte tentuar ta impresionojë Kate Middleton në universitet me aftësinë e tij për të gatuar salcë boloneze. Ata thanë se ta fitosh zemrën e një personi është përmes stomakut dhe duket se kështu saktësisht Princ William ia fitoi zemrën gruas së tij, Kate, në ditët e hershme të lidhjes së tyre.



Ja si duket Kida në xhirimet e klipit të ri

Këngëtarja e njohur e skenës shqiptare, Orhidea Latifi, e njohur me emrin artistik Kida, është në përgatitje të projektit të ri muzikor. Ajo tash e ca ditë është duke qëndruar në Turqi, ndërsa ka zgjedhur disa

vende të veçanta për ta xhiruar videoklipin e ri. Përderisa po argëtohet me miket e saj më të ngushta, bukuroshja shqiptare vjen me fotografi tërheqëse gjatë xhirimeve të klipit në rrjetin social "Instagram".

Teresa dhe Joe Giudice ndahen pas 20 vjetësh martesë



Ka përfunduar martesë në mes të Teresa dhe Joe Giudice. Yjet e "Real Housewives of New Jersey" u ndanë pas 20 vjetësh martesë, ka njoftuar një burim për "People". Ndarja vjen pasi Joe pret një vendim përfundimtar në çështjen e tij të dëbimit pasi u urdhërua që të kthehet në Itali pas 41 muajsh

burgim për akuzë të ndryshme mashtrimi. "Ata diskutuan të ardhmen e tyre kur Tereza dhe vajzat shkuan në Itali në fillim të nëntorit dhe ata ranë dakord se secili duhej të vazhdonte më tej. Ata po e bëjnë këtë në mënyrë miqësore dhe shumë ngadalë", ka thënë ky burim.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ramadani publikon listën për kualifikimet në Itali

"Dardanët" janë në grupin e tretë së bashku me Italinë, Rumaninë dhe Gjeorgjinë, kurse përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, e ka bërë publike listën e hendbollistëve për kualifikueset në Kampionatin Botëror të vitit 2021



PRISHTINË, 18 DHJETOR - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, e ka shpallur të mërkurën listën me emrat e lojtarëve në të cilët llogarit për garën kualifikuese që muajin tjetër mbahet në Itali. Kosova do të garojë në fazën e parë kualifikuese evropiane për Kampionatin Botëror të vitit 2021. "Dardanët" janë në grupin e tretë së bashku me Italinë, Rumaninë dhe Gjeorgjinë.

Më 10 janar Kosova luan me Italinë, më 11 janar me Rumaninë, kurse më 12 janar me Gjeorgjinë. Fituesi i grupit avancoi në raundin tjetër, kurse ndeshjet luhen në Benevento të Italisë. Ramadani ka ftuar 19 lojtarë, ndërsa tre janë debutues në Përfaqësuesen A. Bëhet fjalë për

Albin Xhafollin që kishte luajtur me Përfaqësuesen U21 në Botërorin në Spanjë, portierin Liridon Zena dhe të riun Leonard Gegaj. Liridon Zena është te skuadra kroate Mornar Crikvenica, Xhafolli po luan në Zvicër te skuadra Fortitudo Gossau, kurse Gegaj po zhvillohet te Savehofi i famshëm në Suedi. Në listë janë pesë lojtarë të kampionit të Kosovës, Besa Famgas dhe katër të Prishtinës. Përgatitjet nisin më 27 dhjetor në Prishtinë, ndërsa para udhëtimit në Itali do të luhen dy ndeshje kontrolluese me Kuvajtin. Kosova këtë vit ka shënuar fitore ndaj Izaelit, kurse ka barazuar me Poloninë. Synimi është që me paraqitje të mira të vazhdohet edhe në Itali.

Lista e hendbollistëve

Kastriot Jupa (Besa Famgas), Lindrit Fetahu (Prishtina), Valon Dedaj (HSC Kreuzlingen-Suedi), Flamur Gërbeshi (Amo Handboll-Suedi), Fatlum Ahmeti (LIF Lindesberg-Suedi), Deniz Terziqi (Prishtina), Liridon Zena (Mornar- Crikvenica), Oltion Beshiri (Prishtina), Endrit Abdullahi (Rimbo-Suedi), Egzon Gjuka (Besa Famgas), Petrit Prekazi (Prishtina), Albin Gjafolli (Fortitudo Gossau-Suedi), Luigj Quni (ØIF Arendal-Norvegji), Drlon Tahirukaj (Besa Famgas), Drenit Tahirukaj (Kreuzlingen-Suedi), Haris Berisha (Kempten-Kottern-Gjermani), Bujar Ramosaj (Besa Famgas), Jon Muqolli (Besa Famgas), Lonard Gegaj (IK Savehof-Suedi).

SHKURT

Nesër manifestimi 'Laureatët e vitit 2019'

Federata e Futbollit e Kosovës do ta mbajë manifestimin e saj të përvitshëm "Laureatët 2019" këtë të premte (më 20 dhjetor) në hotel "Emerald" në orën 17:00. Edhe sivjet në këtë gala mbremje tradicionale do të jenë të ftuar mysafirë të shumtë, kurse si zakonisht do të përmbledhen të arriturat e vitit si dhe do të bëhet përzgjedhja e më të mirëve. "Komisioni i caktuar nga KE i FFK-së tashmë i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për këtë manifestim, i cili do të transmetohet drejtpërdrejt në RTK. Të rikujtojmë se vitin e kaluar epiteti i futbollistit më të mirë të vitit i takoi Arbër Zenelit", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Hysaj nuk ka rehati te Napoli, Roma destinacioni i ardhshëm

Elsaid Hysaj është gjithnjë e më larg Napolit. Mbrojtësi shkodran, sipas asaj që raporton media italiane, nuk është as në planet e trajnerit Genaro Gattuso dhe ekipi që po këmbëngul për t'i marrë shërbimet e tij është Roma. Duke qenë se napolitanët kërkojnë të përfitojnë diçka ose, në të kundërt, Hysaj do të largohet me parametra zero në merkaton e verës, nuk duan ta humbin shansin që ta largojnë që në janar.

Luboteni eliminohet nga Challenge Cup

Skuadra e Luboteni (meshkujt) është eliminuar nga garat evropiane në volejball. Luboteni ka pësuar humbje edhe në ndeshjen e kthimit të 1/32 së finales në Challenge Cup nga ekipi turk Spor Toto Ankara. Ndeshja e luajtur të martën në Turqi është mbyllur me rezultatin 3:0 në sete (25:11, 25:11, 25:19) në të mirë të ekipit vendas, që e ka mbyllur ndeshjen për 57 minuta lojë. Luboteni edhe ndeshjen e parë që u zhvillua javën e shkuar në Ferizaj pësoi humbje me rezultatin identik - 3:0. Para Luboteni në kuadër të Challenge Cup, por në konkurrencën e femrave, është eliminuar edhe Drita.

Xhelil Abdulla largohet nga Llapi

Mbrojtësi Xhelil Abdulla nuk do të jetë pjesë e KF Llapit nga Podujeva në sezonin pranveror. Duke parë skuadrën jashtë objektivave të vendosura para fillimit të sezonit, lojtari ka kërkuar largimin, duke gjetur gjuhë të përbashkët me drejtuesit e Llapit për ndërprerje të parakohshme të kontratës që i lidhte palët deri në verë të vitit 2020. Lajmin për ndarjen me Llapin e ka bërë publik vetë Abdulla përmes rrjeteve sociale.

"Faleminderit KF Llapi! Pas gjashtë muajve në KF Llapi të Podujevës, në bisedime me kryesinë e klubit kemi vendosur ta ndërpresim bashkëpunimin. Falënderoj të gjithë në klub, bashkë me tifozët për bashkëpunimin korrekt dhe ju uroj gjithë të mirat në të ardhmen. Me respekt, Xhelil Abdulla", ka shkruar futbollisti tetovar.

Kosova debuton me dy skitarë në Lojërat Olimpike Dimërore

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Ekipi Olimpik i Kosovës do të debutojë në muajin e ardhshëm në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj, "Llozana 2020", të cilat mbahen prej 9-22 janar 2020 në Llozanë të Zvicrës.

Kosovën do ta përfaqësojnë dy skitarët e skijimit alpin: Era Shala dhe Drin Kokaj, të cilët e kanë fituar edhe zyrtarisht të drejtën për të garuar në LOD për të Rinj "Llozana 2020". Shala dhe Kokaj, të dy

16-vjeçarë, janë pjesë e Klubit të Skitarisë Prishtina. Ata garojnë në disiplinat sllalom dhe sllalom i madh, në të cilat do të paraqiten edhe në Llozanë. Kosova do të jetë një prej 11 vendeve që do të deb-

utojnë në edicionin e tretë të këtyre lojërave. Pjesëmarrës në LOD për të Rinj "Llozana 2020" janë 1880 sportistë, prej tyre 940 meshkuj dhe 940 femra, të gjithë të moshës 15-18 vjeç.



Ibra çdo ditë e më larg Milanit e më afër Evertonit

MILANO, 18 DHJETOR - Ndryshe nga sa ishte parashikuar, Zlatan Ibrahimoviç dhe Milani janë shumë larg. Madje çdo ditë që kalon distanca thellohet. Lajmi bëhet i ditur nga mediet italiane. Sipas tyre, klubi kuqezi ka

nisur ta humbasë durimin, pasi sulmuesi suedez po vonon të kthejë përgjigje për ofertën e bërë më shumë se një muaj më parë. Duke qëndruar në atë që raportojnë të përditshmet përtej Adriatikut, që Milani ta prezantonte

Ibrahimoviç si goditjen e madhe në merkato në ditën e 120-vjetorit të krijimit të klubit. Ky objektivi dështoi për meritë të futbollistit, që ende nuk është i bindur nga oferta. Milanistët i kanë propozuar një kontratë gjashtëmujore

me opsion rinovimi edhe për një tjetër vit. Ndërkohë, sulmuesi pretendon menjëherë një kontratë 18-mujore. Në anën tjetër në ishull raportohet se Evertoni është i gatshëm ta rëmbejë sulmuesin shtatllartë.



Lushtaku dhe Isufi ende nuk janë larguar nga Drenica dhe Ferizaj

SKENDERAJ, 18 DHJETOR - Dy trajnerët e skuadrave të IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Tahir Lushtaku (Drenica) dhe Bekim Isufi (Ferizaj), kishin paralajmëruar dorëheqjet e tyre në fund të stinorit vjeshtor, por ende nuk janë zyrtarizuar për shkak të mosorganizimit të klubeve në fjalë, të cilat kaluan në vështirësi të ndryshme gjatë edicionit 2019/20. Trajneri Tahir Lushtaku përsëriti që gjasat që të mbetet te Drenica janë të vogla, por që dorëheqje nuk ka dhënë ende. "Gjasat që unë të vazhdoj janë minimale. Është koha e fundit që të bëhet një zgjidhje e duhur për Drenicën dhe klubi të organizohet si duhet. Unë do të ulem të bisedoj me klubin vetëm nëse klubi do të ketë ndonjë ide apo plan konkret për të ardhmen. Nuk është e rëndësishme nëse unë do të vazhdoj apo jo, por që Drenica të mbetet në elitë dhe të ketë sukses në Kupën e Kosovës, ku i kemi gjasat e mira të kalojmë në gjysmëfinale", ka thënë Lushtaku për "Olle". Ndërsa zyr-



tarët e skuadrës së Ferizajt kanë filluar bisedimet me Bekim Isufin për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në pranverë. Ende nuk është marrë ndonjë vendim nga tekniku gjilanas që, megjithatë,

ka mundësi ta vazhdojë drejtimin e "Ujqërve" edhe në vjeshtë. Muaji dhjetor dhe janar i vitit të ardhshëm do të jenë vendimtarë në lidhje me fatin e dy skuadrave.

Lakersat ndalen pas 14 fitoreve radhazi

Indiana, 18 dhjetor - Skuadra e Lakersave është ndalur pas 14 fitoreve radhazi në kampionat. Ekipi kalifornian është mposhtur me rezultat 105-102 nga Indiana, ndeshje me rivalitet dhe emocione. Sabonis me 26 pikë e 10 rebounde ishte shënuesi më i mirë për Indianan, duke i bërë të pavlefshme 40 pikët e dyshes James-Howard. Për Lakersat nuk u aktivizua Davisi dhe kjo mungesë u ndje në parket. Fiton skuadra tjetër e Los Angelesit, ajo e Clippersave, që mundi me rezultat 120-99 Phoenixin, ndeshje e dominuar nga



vendësit. George me 24 pikë si dhe Leonard e Lou Williams me nga 20 pikë ishin më të mirët për Clippersin. Skuadra e Utah Jazzit, falë 60 pikëve të dyshes Bogdanovic-Mitchell, mundi me përmbysje 109-102 Orlando, duke korrur një tore të rëndësishme për "play-off". Skuadra e Charlottes mposhti 110-102 Sacramento, ndeshje ku difer-

encën e bëri Malik Monk, që e nisi ndeshjen nga stoli dhe realizoi 23 pikë e 10 rebounde. Pas kohës shtesë fiton ekipi i Brooklyn, që mundi me rezultat 108-101 New Orleansin, me Dinwiddie që realizoi 31 pikë. Pa probleme triumfoi New Yorku, që mundi 143-120 Atlantan, ndeshje ku u dallua Barrett me 27 pikë.

SHKURT

Çështje orësh zyrtarizimi i Ancelottit në Everton

Carlo Ancelotti ka arritur marrëveshje me skuadrën e Evertonit, por mungon vetëm zyrtarizimi për shkak se Napoli ende nuk e ka prishur marrëveshjen kontraktuale që e mban ende lidhur me ish-skuadrën e tij teknikun italian. Ancelotti ka rënë dakord që ta drejtojë Evertonin për 4.5 vjetet e ardhshëm, nga e cila do të përfitojë një rrogë të çmëndur: 11.5 milionë paund në vit, plus 2.5 milionë për çdo sezon që "Toffees" do të mbijetojë në Premierë Ligë. Kjo do ta bëjë atë trajnerin e katërt më të paguar në Anglisë, pas Pep Guardiols (20 milionë paund), Jose Mourinhos dhe Jurgen Kloppit (15 milionë paund).

Gattuso e dëshiron Rodriguezin te Napoli

Pasi e mori vendin e titullarit në formacionin e Piolit, Ricardo Rodriguez tashmë shihet si një nga largimet e mundshme të Milanit këtë afat kalimtar të janarit. Sipas medieve italiane, zvicerani është duke u kërkuar me ngulm nga ish-trajneri i tij, tanimë trajneri i skuadrës së Napolit, Gennaro Gattuso.

Katër klube në garë për Haalandin

Erling Haaland shihet nga pjesa më e madhe e klubeve evropiane si sulmuesi i së ardhmes dhe të gjithë e duan. Pavarësisht se është vetëm 19-vjeçar, ka konfirmuar se është gati të luajë në nivele të larta. Ajo që josh më shumë është çmimi që Haaland ka mbi kontratë, 30 milionë euro, një shumë më se e pranueshme për pjesën më të madhe të klubeve. Juventus, Manchester Unitedi dhe dy klubet gjermane Borussia Dortmund dhe Leipzig janë në garë për transferimin e sulmuesit të talentuar.

Perini drejt rikthimit te Genoa


Mattia Perin mund të rikthehet te Genoa. Sipas medieve italiane, Juventus ka nisur tratativat me drejtuesit e klubit kuqeblu për portierin i cili në verë ishte shumë pranë transferimit te Benfica. I rritur te Genoa, 27-vjeçari u largua nga klubi për t'u transferuar në verën e vitit 2018 për shumën e 12 milionë eurove pikërisht te "Zonja e Vjetër", por pa arritur kurrë të jetë protagonist me bardhezinjtë. Perin ka zbritur në fushë me fanellën e Juventusit vetëm 9 herë. Kjo është arsyeja që portieri kërkon të largohet, pasi dëshiron të luajë rregullisht dhe ish-ekipi i tij mund të jetë alternativa më e mirë për të.

Zhang: Interi do ta pushtojë botën

Presidenti i Interit, Steven Zhang, ka thënë se një Inter i bashkuar do ta "pushtojë botën" gjatë fjalimit të tij në darkën e klubit për Krishtlindje. "Nerazzurrit" po e sfidojnë Juventusin për "Scudetto" këtë sezon dhe për momentin e ndajnë vendin e parë në Itali me 39 pikë nga 16 ndeshje. "Tani për tani, ne jemi në krye të Serisë A. Kjo do të thotë shumë për ne. Do të thotë që jemi në rrugën e duhur. Të gjitha përpjekjet tona do të shpërblehen hap pas hapi. Ende kjo nuk do të thotë asgjë. Ne duhet të qëndrojmë të përlulur. Duhet të mësojmë nga e kaluara. Duhet të qëndrojmë të përqendruar. Pa guxim dhe punë, ne nuk mund të konkurrojmë në nivelin më të lartë. Të dyja dhe jashtë fushës. Javën e kaluar fola me lojtarët dhe thashë që do të kemi disa vështirësi në të ardhmen, gjithmonë ka pengesa për t'u kapërcyer. Kjo vlen edhe për 100 vjetet e ardhshëm të këtij klubi. Gjithmonë do të ketë pengesa, por ne duhet të përballemi së bashku", ka thënë Zhang. "Ne nuk kemi frikë nga asgjë. Sot, dhe në të ardhmen, do të marr guxim. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të aspirojmë dhe të konkurrojmë në nivelet më të larta. Vështirësitë e së kaluarës nuk kanë rëndësi. Pengesat në të ardhmen nuk kanë rëndësi. Së bashku, të gjithë ne, kjo familje e madhe, do ta pushtojmë botën. Të gjithë jemi të bashkuar. Forza Inter", ka deklaruar Zhang.

REZULTATET

Charlotte - Sacramento	110-102
Indiana - Lakers	105-102
New York - Atlanta	143-120
New Orleans - Brooklyn	101-108
Utah Jazz - Orlando	109-102
Clippers - Phoenix	120-99



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

FTESË PËR OFERTË

Procedure e shitjes në bazë të rregullores së KRPP-së - Rregullat mbi Qeverisjen e Shitjes dhe Vendosjen e Aseteve, datë 24 Janar 2012, dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderimit në KEK, për Shitje të Aseteve të Luajtshme, datë 15 Shtator 2009.

SHITJA E QYMYRIT TË THËRMUAR

Procedure e Shitjes

Nr. KEK-SHQ -19-005-811

Korporata Energjetike e Kosovës sh. a. (KEK), me këtë rast, fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë dokumentet e tenderimit.

Metoda që do të përdoret -shitja përmes ofertave publike të mbyllura për sasinë: **800,000 t**

Blerësi fitues do të marrë qymyrin me pajisje disokontinuale në deponin e TC Kosova B, duke përdorur pajisjet vetjake – për përdorim vetjak apo për shitje të mëtutjeshme.

Ky aktivitet do të zhvillohet me procedurë të hapur me një zarf

Vizita në Vendndodhje : **26.12.2019** prej orës **10:00**- KEK , Divizioni i Prodhimit të Qymyrit,

Drejtoria Hyrja 01, Kastriot - e dëshirueshme

KEK fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre me se voni me datë **06.01.2020** në ora **13:00**, ndërsa hapja e ofertave me **06.01.2020** në ora **13:30**.

Kërkesat për tërheqjen e dosjes së tenderit drejtohen në adresat vijuese:

Email: emin.tmava@kek-energy.com ose bledar.racaj@kek-energy.com

www.kek-energy.com

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtorija e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 11/01-39688 /2019
Kaçanik, 18.12.2019

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtorija e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „Emin Duraku” në Kaçanik:

Një mësimdhënës i mësimin klasor,
Një mësimdhënës i mësimin klasor, zëvendësues pushim i lehonisë,
Një mësimdhënës i lëndës, gjuhë gjermane, zëvendësues pushim i lehonisë dhe
Një mësimdhënës e edukatës muzikore, zëvendësues pushim i lehonisë .

2. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Idriz Seferi” në Bob:

Një mësimdhënës i mësimin klasor, paralelja e ndarë fizike Gajre, zëvendësues pushim i lehonisë.

3. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Nazmi Osmani” në Elezaj:

Një mësimdhënës i mësimin klasor.

4. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Qamil Ilazi “ në Kaçanik të Vjetër:

Një mësimdhënës i lëndës, gjuhë shqipe, me kohë të caktuar.

5. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Kadri Zeka” në Dubravë:

Një mësimdhënës i lëndës, gjuhë shqipe, me 14 orë.

6. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Agim Bajrami” në Stagovë:

Një mësimdhënës i mësimin klasor.

7. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Ali Asllani” në Doganaj:

Një mësimdhënës i mësimin klasor, zëvendësues pushim i lehonisë.

8. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „ Dituria” në Ivajë:

Një mësimdhënës i mësimin klasor, paralelja e ndarë fizike Strazhë,
Një mësimdhënës i lëndës, teknologji informative, me 12 orë.

9. Gjimnazi “Skënderbeu” në Kaçanik:

Një mësimdhënës i lëndës, fizikë, me 10 orë.

10. Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Caka” në Kaçanik:

Një mësimdhënës i lëndës, teknologji informatikë, zëvendësues pushim i lehonisë.

11. QEAP “Agimi” në Kaçanik:

Tri motra edukatore,
Dy edukatore,
Një ndihmëskuzhinier/serviuere dhe
Një punëtor teknik (pastrues)

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës për mësimdhënës:

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtares, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë për motër edukatore:

- Kujdes fizik dhe emocional ndaj fëmijëve;
- Raportimi i çfarëdo shqetësimi për zhvillimin apo shëndetin e çilitdo fëmijë /individualisht/ drejtorit të IP;
- Ndërtimi i raporteve dhe komunikimit profesional miqësor dhe bashkëpunues me prindër, kolegë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm;
- Të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara nga drejtori i IP.

Detyrat dhe përgjegjësitë për edukatore:

- Mbajtja e komunikimit të hapur me prindërit dhe ofrimi i informatave korrekte lidhur me mbarëvajtjen e fëmijës;
- Organizimi i materialeve dhe pajisjeve të përdorura sipas metodologjisë të përcaktuar të IP;
- Përdorimi i aktiviteteve të ndryshme sikur (këndimi, rrëfimi, lojërat e strukturuar, arti, aktivitetet jashtëshkollë) për stimulimin dhe rritjen e aftësive të fëmijëve;
- Bashkëpunim i ngushtë me stafin e IP;
- Të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara nga drejtori i IP.

Detyrat dhe përgjegjësitë për ndihmëskuzhinier/ serviuere:

- Përkujdeset për mirëmbajtjen/përkujdesjen për pajisjet e kuzhinës dhe ambientin të brendshëm të IP;
- Shpërndarjen e ushqimit për fëmijët e institucionit parashkollor;
- Kryen edhe punë tjera të cilat i cakton drejtori i IP.

Detyrat dhe përgjegjësitë për punëtor teknik:

- Pastron dhe mirëmban të gjitha ambientet e IP;
- Kujdeset për pasurinë e IP, brenda dhe jashtë objektivit;
- Kujdeset për mjetet e punës dhe materialin shpenzues për mirëmbajtjen e higjienës;
- Kryen edhe punë tjera të cilat i cakton drejtori i IP.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për ndihmëskuzhinier/serviuere:

- Diplomën e shkollës së mesme, certifikata për aftësitë profesionale;
- CV- në;
- Letër motivuese;
- Dëshminë se nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës (kopje).

Dokumentet e nevojshme për aplikim për punëtor teknik:

- Diplomën e shkollës së mesme, certifikata për aftësitë profesionale;
- CV- në;
- Letër motivuese;
- Dëshminë se nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës (kopje).

Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs :

Për vendet e punës për mësimdhënës, motër edukatore dhe edukatore, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.
Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim (nëse ka), dëshminë se nuk është nën hetime, CV- në dhe kopjen e letërnjoftimit.

Të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas dispozitave ligjore, do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar. Vetëm kandidatët që arrijnë së paku 50% të testit me shkrim, ftohen në interviste me gojë.

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen dhe kandidatët me më shumë pikë sistemohehen në vendet e punës.

Njoftimet e kandidatëve për testin dhe orarin e intervistave bëhen në web-faqen e Komunës dhe përmes email-it (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit).

Për të njëjtën pozitë kandidati plotëson vetëm një aplikacion ndërsa vendin e punës e zgjedh ai që ka më së shumti pikë për atë pozitë.

Fillimi i punës për vendet e lira do të përcaktohet në varësi të liritimit real të vendit të punës (data e pensionimit apo pushimit të lehonisë).

Afati dhe mënyra aplikimit.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-Zyra e Pranimit, kati përdhës.



Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 19.12.2019 deri 02.01.2020.

Drejtori i drejtorisë
z. Zahir Doda

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Ramstone” Sh.p.k Klinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe vendosja e seperacionit në Dresnik komuna e Klinës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.01.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Guri i Zi” në Vullajk komuna e Klinës do të organizohet debat publik nga kompania “Ramstone” Sh.p.k Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe vendosja e seperacionit në Dresnik komuna e Klinës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Uprava za obrazovanje i kulturu
04 broj: 111/01-396 2019
Kačanika 18. 12. 2019.

Prema članku 5 (c) Zakona o obrazovanju u općinama Republike Kosovo br.03 / L-068, članku 35 Zakona o pred univerzitetskom obrazovanju br.04 / L-032, članku 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulaciji postupaka natjecanja u javnom sektoru, Administrativno uputstvo MONT-a br.10 / 2018, o normativu o stručnom okviru općeg obrazovanja, Uprava za obrazovanje i kulturu, objavljuje:

Oglas za regrutovanje

Za popunjavanje slobodnih radnih mjesta

- Niža srednja osnovna škola "Emin Duraku" u Kačaniku:
Učitelj u učionici,
Učiteljica u učionici, zamjena za porodični dopust,
Predmetna učiteljica, njemački jezik, zamjena porodijskog dopusta i
Nastavnik glazbenog obrazovanja, zamjena za porodični dopust.
- Donja osnovna škola Idriz Seferi u Bobu:
Učiteljica u učionici, odvojeni fizički razred Gajre, zamjena porodijskog dopusta.
- Donja osnovna škola Nazmi Osmani u Elezaju:
Učiteljica u učionici.
- Donja osnovna škola Qamil Ilazi u Starom Kačaniku:
Predmetni nastavnik, albanski jezik, honorarno.
- Niža osnovna škola „Kadri Zeka“ u Dubravi:
Predmetni učitelj, albanski, s 14 sati.
- Donja osnovna škola Agima Bajrami u Stagovu:
Učiteljica u učionici.
- Niža osnovna škola Ali Asllani u Doganaju:
Učiteljica u učionici, zamjena porodijskog dopusta.
- Osnovna škola nižeg znanja "Dituria" u Iva:
Učitelj u učionici, fizički podijeljeni paralelni niz,
Predmetni učitelj informatike, s 12 sati.
- Gkena Skenderbeu u Kačaniku:
Predmetni učitelj fizike, s 10 sati.
- Srednja strukovna škola "Braća Feriz i braća Chaka" u Kačaniku:
Predmetni učitelj, računalna tehnologija, zamjena porodijskog dopusta.

II. QEAP "Zora" u Kačaniku:

- Tri njegujuće sestre,
- Dva odgajatelja,
- Kuhar / sluga i
- Tehnički radnik (čistač)

Obveze i odgovornosti za posao nastavnika:

- Provesti nastavni plan i program za odgovarajuće radno mjesto, u skladu s važećim zakonodavstvom, kojim se reguliraju relevantna područja za njegovo radno mjesto;
- Izvršavati radne zadatke koji osiguravaju profesionalnu kvalitetu i kompetentnost u nastavnom procesu;
- Pripremiti nastavni plan i program u skladu s Nuklearnim kurikulumom.
- Primijeniti nove metodologije poučavanja i ocjenjivanja u skladu sa smjernicama kurikuluma;
- Vodite osobni dnevnik procjene učenika;
- aktivno sudjelovati u izvannastavnom učenju s učenicima i odgovorno provoditi izlete sa učenicima u zemlji i inozemstvu, prema uputama ravnatelja škole;
- Poštujte izravne ovlasti službenika kojem podnosi izvještaj i obavlja dužnosti koje su mu povjerene. Radne dužnosti moraju biti u skladu s važećim zakonodavstvom.

Dužnosti i odgovornosti sestara:

- tjelesna i emocionalna briga o djeci;
- Izvještavanje o bilo kakvoj zabrinutosti zbog razvoja ili zdravlja bilo kojeg djeteta / pojedinačno / IP direktora;
- Izgradnja prijateljskog i suradničkog profesionalnog odnosa i komunikacije s roditeljima, vršnjacima i vanjskim suradnicima;
- Obavljati druge dužnosti koje je odredio ravnatelj IP-a.

Dužnosti i odgovornosti odgajatelja:

- Održavanje otvorene komunikacije s roditeljima i pružanje točnih informacija o djetetovoj dobrobiti;
- Organizacija materijala i opreme koji se koriste u skladu s definiranom IP metodologijom;
- Korištenje različitih aktivnosti kao što su (pjevanje, pripovijedanje, strukturirane igre, umjetnost, izvannastavne aktivnosti) za poticanje i unapređenje dječijih sposobnosti;
- uska suradnja s IP zaposlenicima;
- Obavljati druge dužnosti koje je odredio ravnatelj IP-a.

Dužnosti i odgovornosti pomoćnog kuhara:

- Vodi brigu o održavanju / njezi kuhinje i opreme za okoliš internog IP;
- Distribucija hrane predškolskoj djeci;
- Obavlja i druge zadatke koje mu dodijeli direktor IP.

Dužnosti i odgovornosti tehničkog radnika:

- Čisti i održava sva IP okruženja;
- Vodi brigu o IP imovini, unutar i izvan objekta;
- brine se o alatu i potrošnom materijalu za održavanje higijene;
- Obavlja i druge zadatke koje mu dodijeli direktor IP.

Potrebni dokumenti za uporabu u kuhinji / servisiranju:

- srednjoškolska diploma, potvrda o stručnim vještinama;
- životopis;
- popratno pismo;
- Dokaz da nije pod istragom
- osobna iskaznica Republike Kosovo (kopija).

Potrebni dokumenti za prijavu tehničkog radnika:

- srednjoškolska diploma, potvrda o stručnim vještinama;
- životopis;
- popratno pismo;
- Dokaz da nije pod istragom
- osobna iskaznica Republike Kosovo (kopija).

Uvjeti sudjelovanja na natječaju:

Za rad nastavnika, sestara i odgajatelja potrebno je odgovarajuće stručno usavršavanje prema Administrativnom uputstvu MONT-a br. 10/2018 o stručnom okviru općeg obrazovanja.

Da bi se prijavili, kandidati moraju ispuniti sljedeću dokumentaciju: odgovarajuću fakultetsku diplomu, izvod iz matične knjige rođenih, dokaz o radnom iskustvu u obrazovanju (ako postoji), dokaz da nije pod istragom, kopiju životopisa i lične karte.

Svi kandidati koji ispunjavaju uvjete natječaja prema zakonskim odredbama bit će podvrgnuti pismenom testiranju. Pismeni test maksimizira 100 bodova ili 50% završne ocjene. Na usmeni razgovor pozivaju se samo kandidati koji polože najmanje 50% pismenog testa.

Ocjene iz pismenog testa i usmenog razgovora prikupljaju se, a kandidati s najviše bodova postavljaju se na radno mjesto.

Kandidati su obaviješteni o rasporedu ispitivanja i intervjua na web stranici Općine i putem e-pošte (prema podacima u prijavi kandidata).

Za istu poziciju kandidat ispunjava samo jednu prijavu, a posao koji odabere onaj koji ima najviše bodova.

Slobodna radna mjesta određivat će se ovisno o stvarnom slobodnom radnom mjestu (datumu odlaska u mirovinu ili roditeljskom dopustu).

Rok i način prijave.


Prijavni obrasci se zaprimaju i predaju Centru za usluge građanima - Prijemnoj službi, prizemlje.

Svi dokumenti tijekom prijave trebaju biti kopije, dok bi se original trebao donijeti na dan intervjua.

Nepotpuni i dospjeli dokumenti neće se pregledati.

Kandidati za odabir i intervju bit će obaviješteni putem e-maila ili javnog odbora za objavu.

Natječaj ostaje otvoren 15 dana od dana objave u medijima od 19.12.2019 do 02.01.2020.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Betim Verbovci, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme teknike "28 Nëntori" Prishtinë.
- Alban Ukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Dëshmorët e Kabashit " Korishë.
- Mejzin Flugaj shpall te pavlefshme dëftesën e vitit I shmlt "11 Marsi" Prizren
- Eltis Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizren
- Naim Muhaxheri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Leke Dukagjini" Prizren
- Hamide Kelmendi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net